



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. <u>02</u>	Nr./Br./No. <u>21027</u>
Nr. i faq. Br. Str. No. Pg. <u>223</u>	Data Datum Date <u>27/07/</u>
KAMENICË - KAMENIC <u>2026</u>	

**Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026
(Janar-Qershor)**

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Shqyrton dhe miraton: Kuvendi Komunal i Kamenicës

Kamenicë, 2026

Përmbajtja:

Grupi punues.....	3
Hyrje.....	4
Zyra e Informimit	5-6
Zyra e Integrimeve Europiane.....	7-9
Zyra Ligjore.....	9-11
Zyra e Personelit	12-20
Zyra e Prokurimit.....	21
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.....	22-36
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.....	37-45
Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....	46-56
Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.....	57-65
Drejtoria për Komunale e Arsimit	66-99
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	100-162
Drejtoria për Investime Kapitale.....	163-168
Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë.....	168-197
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.....	198-208
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	209-223

Grupi punues:

1. Kryetari i Komunës së Kamenicës-Kadri Rahimaj,
2. Nënkryetare e Komunës së Kamenicës-Arta Bajralija,
3. Shef i Kabinetit të Kryetarit-Vaxhid Rexhepaj,
4. Zyra e Personelit -Shuajb Lakna,
5. Zyra Ligjore-Riad Rahimaj,
6. Zyra e Prokurimit-Urim Thaqi,
7. Zyra e Informimit-Lidiona Marovca, Valdete Berisha-Murina,
8. Zyra e Integriteteve Europiane-Zijadin Thaqi,
9. Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme-Arlindë Sejdiu,
10. Drejtoreshë e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet-Ardita Dërmaku,
11. Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit-Selami Klaiqi,
12. Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-Uran Berisha,
13. Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Besart Kryeziu,
14. Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë-Zotrim Kastrati,
15. Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë-Edon Dërmaku,
16. Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Shpend Morina,
17. Drejtoreshë e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi-Burbuqe Leka,
18. Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Afrim Dervishi,
19. Drejtor i Drejtorisë për Investime Kapitale-Blerim Murina.

Hyrje:

Ky ka qenë gjashtëmuji i parë i vitit 2026, njëkohësisht edhe gjashtëmuji i parë i këtij mandati qeverisës. Gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar me përkushtim realizimin e projekteve të nisura më herët, duke siguruar që investimet e planifikuara të ecin sipas dinamikës së paraparë dhe të japin rezultatet e pritura për qytetarët tanë.

Përveç përfundimit të projekteve që kanë qenë në proces, kemi punuar intensivisht edhe në planifikimin dhe hartimin e projekteve të reja, duke u bazuar në nevojat reale të qytetarëve dhe prioritetet zhvillimore të komunës sonë. Në çdo vendim dhe investim, fokusi ynë ka qenë përmirësimi i shërbimeve publike, avancimi i infrastrukturës, krijimi i hapësirave më të mira për arsim, kulturë e sport, si dhe ofrimi i mundësive të reja për zhvillim ekonomik lokal.

Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi zhvilluar takime të shumta me institucione vendore e ndërkombëtare, organizata partnere dhe donatorë potencialë, duke kërkuar vazhdimisht mundësi të reja bashkëpunimi dhe financimi. Këto angazhime kanë për qëllim jo vetëm sigurimin e investimeve të reja, por edhe krijimin e partneriteteve të qëndrueshme që do të kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë të komunës sonë.

Rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe janë dëshmi e përkushtimit të administratës komunale dhe e bashkëpunimit të mirë me të gjithë akterët relevantë. Megjithatë, ne e shohim këtë gjashtëmuji jo vetëm si një periudhë pune të realizuar, por edhe si një bazë të fortë për projektet dhe iniciativat që na presin në pjesën e dytë të vitit. Me të njëjtin përkushtim dhe vizion, do të vazhdojmë të punojmë për një komunë më të zhvilluar dhe me më shumë mundësi për secilin qytetar.

Zyra e Kryetarit

Komuna e Kamenicës

Zyra për Informim:

Të Dhënat Lidhur me Publikimin e Vendimeve/Kontratave

Tabela nr. 1

Drejtoritë/Zyret	Publikimet
Zyra e Kryetarit	63 Vendime 8 Njoftime per Diskutim Pubik 15 Raporte, procesverbale dhe memorandume shpjeguese nga këto diskutime publike 200 Lajme dhe Informata të publikuara në Ueb-faqen zyrtare dhe në Facebook-un zyrtar të Komunës së Kamenicës
Kuvendi	6 Mbledhje të Kuvendit Seanca I- 10 Dokumente të shqyrtuara Seanca II- 2 Dokumente të shqyrtuara Seanca III- 9 Dokumente të shqyrtuara Seanca IV- 8 Dokumente të shqyrtuara Seanca V- 6 Dokumente të shqyrtuara Seanca VI- 12 Dokumente të shqyrtuara 10 Vendime 5 Draft-rregullore

Zyra e Personelit	20 Konkurse, Shpallje 67 Njoftime për publikim të rezultateve të konkurseve, shpalljeve etj.
-------------------	---

Kërkesat për Qasje

Tabela nr. 3

Kërkesat e paraqitura	Numri	Kthimi i Përgjigjeve
Me postë elektronike	4	4
Kopje fizike	0	
Postë elektronike dhe kopje		
Verbalisht		

Zyra për Integritet Evropian:

Gjatë periudhës gjashtë mujore për periudhën Janar-Qershor, Zyra Komunale për Integritet Evropian ka realizuar këto aktivitete:

Aktivitetet e rregullta të Zyrës Komunale për Integritet Evropian

- Siguroam implementimin e PVMSA-së (Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit) për veprimet që ndërlidhen me Komunën dhe raportuam sipas kërkesave të MAPL-së.
- Koordinuam aktivitetet e Komunës që lidhen me implementimin e PVMSA-së.
- Mbikëqyrëm aktivitetet e institucioneve komunale që burojnë nga PVMSA, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës.
- Mbikëqyrëm hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar përputhshmërinë me standardet evropiane.
- Raportuam te Kryetari i Komunës për aktivitetet e drejtorive për periudhën 6-mujore përmes raportit-matricës.
- Përgatitëm materiale të nevojshme për çështjet që lidhen me integritet evropian.
- Hulumtuam programe të ndryshme të asistencës së BE-së që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal.
- Ofruam këshilla lidhur me çështjet evropiane sipas nevojave të Komunës.
- Bashkëpunuam me Zyrën për Integritet Evropian në MAPL dhe me Agjencionin për Integritet Evropian në çështjet e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.
- Monitoruam punën e Kuvendit Komunal, Komiteteve dhe morëm pjesë në diskutime publike.

Detyra dhe angazhimet shtesë me urdhëresë të Kryetarit të Komunës

- Zyrtar kryesor ndërlidhës për deklarimin e pasurisë në Agjencionin Antikorrupsion (tani jam liruar, kompetencë e Burimeve Njerëzore).

- Anëtar i Komisionit për Ankesa – shkalla e dytë për Inspeksion, Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim pa Leje (në vazhdimësi).
- Zyrtar ndërlidhës mes Komunës dhe Agjencionit Antikorrupsion për konflikt interesi.
- Zyrtar përgjegjës për Zbatimin dhe Monitorimin e Planit të Integritetit.
- Anëtar i Komisionit për hartimin e planit për banim social.
- Pjesëmarrje në disa komisione për rekrutim.
- Takime me Kolegjin e Zyrtarëve Komunalë për Integritet Evropian për hartimin e matricës së PVMSA-së.
- Takime me Kolegjin për Diasporë në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- Përgatitja e raportit të “Planit Gjithpërfshirës të Komunave, Janar-Qershor 2026”, për MAPL.
- Kryerja e shumë punëve, këshillimeve dhe rekomandimeve shtesë sipas nevojave të Komunës, brenda dhe jashtë saj, në nivel regional dhe qendror.
- Kryesues i grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm, Integritetit të huajve për Komunën e Kamenicës për periudhën 2026 – 2028.

Trajnimet, seminarët dhe punëtoritë e ndjekura

Gjatë kësaj periudhe kam ndjekur këto aktivitete profesionale:

- Hartimi i planit për Riintegrim dhe kthim të qëndrueshëm , si dhe testet psiko-sociale.
- Trajnime për marrëveshje ndërkomunale, ndërkombëtare dhe binjakëzim etj.
- Punëtori në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Konferencë me shefin e zyrës së BE-së në Prishtinë dhe me grupin punues të Kosovës për rrugëtim drejt BE-së.

Zyra Ligjore:

Ky raport paraqet aktivitetet dhe angazhimet kryesore të Zyrës Ligjore gjatë periudhës 01 janar 2026 deri më 23 qershor 2026, në funksion të ofrimit të mbështetjes juridike për Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës dhe drejtoritë komunale të Komunës së Kamenicës.

HARTIMI DHE SHQYRTIMI I AKTEVE JURIDIKE

Gjatë periudhës 01.01.2026 – 23.06.2026, Zyra Ligjore ka hartuar dhe proceduar këto akte:

Raporti statistikor 01 Janar – 19 Qershor, 2025	Gjithsej:
Aktivitetet	
Thirrje Publike	1
Kontrata	0
Propozim vendime	47
Vendime për formimin e grupeve punuese	7
Vendime, plotësime, ndryshime, korrigjime dhe shfuqizime të akteve administrative	6
Vendime financiare	38
Vendime për ndryshime në projekte	1
Vendime për formimin e komisioneve	32

Autorizime	2
Delegime të kompetencave dhe përgjegjësi	5
Vendime për aprovimin e rekomandimeve	8
Vendime për emërimin e menaxherit në memorandume bashkëpunimi	1
Vendime për caktimin e zyrtarëve përgjegjës	2

Vendime për formimin e ekipeve monitoruese	2
Plane të Zyrës Ligjore	2
Vendime të ndryshme	1

Gjithsej:	155
------------------	------------

OPINIONE DHE KËSHILLA JURIDIKE

Gjatë periudhës raportuese, Zyra Ligjore ka ofruar mbështetje të vazhdueshme juridike për Zyrën e Kryetarit, Nënkryetares e Komunës dhe drejtoritë komunale të Komunës, përmes:

- Ofrimit të opinioneve juridike lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi;
- Shqyrtimit juridik të çështjeve administrative, kontraktuale dhe procedurale;

- Hartimit të përgjigjeve dhe interpretimeve juridike sipas kërkesave të drejtorive komunale;
- Këshillimit juridik për komisionet dhe grupet punuese të themeluara nga Komuna.

PJESËMARRJA NË KOMISIONE DHE GRUPE PUNUESE

Zyra Ligjore ka marrë pjesë dhe ka ofruar mbështetje profesionale në komisione dhe grupe të ndryshme punuese, duke kontribuar në sigurimin e ligshmërisë së proceseve administrative dhe vendimmarrëse të Komunës.

TAKIME DHE KOORDINIM INSTITUCIONAL

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime të rregullta pune me:

- Kryetarin dhe Nënkryetaren e Komunës;
- Drejtorët e drejtorive komunale; dhe
- Zyrtarë nga institucionet qendrore dhe lokale.

Këto takime kanë pasur për qëllim koordinimin e çështjeve juridike dhe administrative me interes për Komunën.

TRAJNIME DHE ZHVILLIM PROFESIONAL

Gjatë periudhës raportuese, zyrtarët e Zyrës Ligjore kanë marrë pjesë në:

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete në kuadër të trajnimeve dhe zhvillimit profesional:

- Takimi i parë i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor për vitin 2026, ku u diskutua dhe u miratua Plani i Punës së Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor për vitin 2026.

- Takimi i dytë i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, ku u diskutua zbatimi i Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil.
- Takimi i tretë i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, Hartimi i Model-Rregullores për Politikat e Privatësisë.
- Trajnimi “Shqyrtimi Administrativ i Akteve të Komunave” – Z. Riad Rahimaj, Z. Shuajb Lakna dhe Z. Liridon Rexhepaj, të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën “Shqyrtimi Administrativ i Akteve të Komunave”.
- Trajnimi “Hartimi i Planeve Komunale” – Z. Riad Rahimaj dhe Z. Enis Fazliu, të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën “Hartimi i Planeve Komunale”.

PËRMBLEDHJE

Gjatë periudhës 01.01.2026 – 23.06.2026, Zyra Ligjore ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ofruar mbështetje juridike profesionale për Kryetarin e Komunës, Nënkyetaren e Komunës dhe drejtoritë e Komunës së Kamenicës. Aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në sigurimin e ligjshmërisë së akteve, procedurave administrative dhe proceseve vendimmarrëse të Komunës.

Zyra e Personelit:

Ky raport paraqet punën e NJMBNJ-së për periudhën (6) mujore, Janar-Qershor 2026. Raporti përmbledhë të gjitha aktivitetet e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u përfshirë në punët dhe detyrat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së NJMBNJ-së të cilat do të paraqitën në mënyrë tabelare.

Si një nga objektivat kryesore brenda kësaj periudhe për NJMBNJ (Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore), ka qene finalizimi i Rregullores për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës, e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal dhe tani jemi në pritje të konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria përkatëse.

Në vazhden e planifikimeve dhe organizimit të vendeve të punës për vitin 2026, Komuna e Kamenicës -NJMBNJ ka autorizim për zhvillimin e procedurave sipas nevojave për kapacitet të burimeve njerëzore pozitat e zyrtarëve publikë, të cilat përfshijnë shërbimin civil, shërbimin publik (arsimin dhe shëndetësinë), si dhe personelin administrativ dhe mbështetës.

Tek kategoria **Shërbimin publik**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit njëkohësisht publikimi i konkurseve bëhet në ueb-faqën zyrtare të komunës,

Tek kategoria **Sherbimin publik**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit njëkohësisht publikimi i konkurseve bëhet në ëeb faqën zyrtare të komunës,

Nr.	Pozita	Nr. Ref.	Nr. i Aplikuesve	Nr. i aprovuar	Nr. i refuzuar	Nr. kandidatëve fitues	Statusi i procedures rekrutuese
1.	Konkurs për Pranim, Zyrtar Koordinator/e	RN00019433	2	1	1	1	Mbyllur/ Në procedure te

	për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore						afatit të ankesave
2.	Konkurs për pranim, Mjek të përgjithshëm	RN00019376	24	19	5	2	Mbyllur/ Në procedure te afatit të ankesave
3.	Konkurs për Pranim, pozita Drejtor të Institucionit Parashkollor	RN00019463	1	1	0	1	Përfunduar i suksesshëm,
4.	Konkurs për Pranim, pozitat Drejtor IEAA-AP	RN00019485	8	8	0	8	Përfunduar i suksesshëm, ndërsa nuk ka pasur aplikues për SHFMU "Xhelal Sopi".
5.	Konkurs për Pranim,	RN00019567	5	1	4	0	Në pritje

	Bashkëpunëtor Profesional - Psikolog/e						
6.	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Violines (Kohe te caktuar)	RN00019342	1	1	0	1	Përfunduar i suksesshëm,
7.	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e TIK & Matematikë (Kohe te caktuar)	RN00019341	2	2	0	2	Përfunduar i suksesshëm,
8.	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Kimisë	RN00019379	2	1	1	1	Përfunduar i suksesshëm,

	(Kohe te caktuar)						
--	-------------------	--	--	--	--	--	--

Tek kategoria **Sherbimi civil (Marrëdhënie kontraktuale – Zëvendësim apo realizim të projektit)**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit SMBNJ njëkohësisht publikimi i konkurseve bëhet në ëeb faqen zyrtare të komunës,

Nr.	Pozita	Nr. Ref.	Nr. i Aplikuesve	Nr. i aprovuar	Nr. i refuzuar	Nr. kandidatëve fitues	Statusi i procedures rekrutuese
1.	Zyrtar Administrativ – Projekt	RN00019885	6	0	0	0	Anuluar
2.	Asistent administrativ	RN00019781	7	4	3	3	Mbyllur/ Në procedure te afatit të ankesave
3.	Zyrtar Administrativ – Projekt	RN00019780	2	1	1	1	Mbyllur/ Në procedure te afatit të ankesave
4.	Asistent administrativ	RN00019779	6	5	1	2	Mbyllur/ Në procedure te afatit të ankesave

Tek kategoria **Administrativ/Mbështetës**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit SMBNJ njëkohësisht publikimi i konkurseve bëhet në ëeb faqen zyrtare të komunës, mirëpo gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa apo nevoja të rritjes se kapaciteteve brenda kesaj kategorie.

Në vazhden e realizimit të detyrave dhe përgjegjësiqe që ndërliqhen kryesisht me veprimtarinë e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, gjatë periudhës gjashtëmujore të vitit 2026 janë hartuar, shqyrtuar dhe proceduar aktet administrative dhe dokumentet zyrtare si në vijim:

Nr	Emërtimi i Aktit	Të paraqitur në numër
1.	Vendim për pensionim të nëpunësit	2
2.	Vendim për pezullimin e vendit të punës	3
3.	Vendim për ndalim të pagës	3
4.	Shpallje publike (procedur e thjeshtësuar)	5
5.	Vendim për caktim (ushtrues detyre)	5
6.	Vendim për ndalesë në pagë	2
7.	Vendim për formimin e komsionit	10
8.	Kontratë pune për kohë të caktuar	11
9.	Kontratë pune për punë dhe detyra specifike	11
10.	Vendim për lejimin e mjeteve financiare avanc për udhëtime jashtë vendit	8
11.	Marrëveshje për vëllim të shtuar të punës	2
12.	Vendim për lirim nga detyra (U.D)	5

13.	Marrëveshje për pune praktike në Shtëpinë Rezidenciale	1
14.	Vendim për emërimin e Nënkryetares	1
15.	Vendim për lejimin e pushimit me kompensim 70% të pagës	3
16.	Vendim për kompensimin e punës jashtë orarit të rregullt në vlerë monetare	10
17.	Vendim për emërim Drejtor	12
18.	Vendim për lirim nga detyra e Drejtorit	7
19.	Vendim për shfuqizimin e vendimit për pezullim	4
20.	Vendim për pezullim të marrëdhënies së punës	2
21.	Vendim për përjashtim nga procedura, shkak konflikt interesi	1
22.	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Komisionit Diciplinor për Shërbyesit Publikë	1
23.	Vendim për caktimin e Zyrtarit kontaktues ndërmjet APK dhe KK	1
24.	Vendim për shkëputjen e marrëveshjes së Bashkëpunimit me Komunën e Leposaviqit	1
25.	Vendim për lejimin e pushimit pa pagesë	3
26.	Vendim për transferimin dhe sistemimin e nëpunësit teknik	1
27.	Vendim për ndryshim-plotësim të Kodit Buxhetor	19
28.	Njoftim për refuzimin e aplikacionit	4
29.	Vendim për pushimin e lehonisë	2
30.	Vendim për lirim nga detyra në shërbimin civil	2

31.	Ndryshim dhe plotësim i vendimit për formimin e komisionit të pranimit për pozitën e punës hartues i projekteve	1
32.	Vendim për lirim nga detyra	2
33.	Vendim për emerim	2
34.	Vendim për caktim ZKF	1
35.	Vendim për përjashtim nga lista e pagave 78 Antarë të Komisionit	1
36.	Vendim për kompensim të diferencës në pagë	3
37.	Vendim për ndalesë në pagë sipas marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar	1
38.	Vendim për kompensimin e pagës	2
39.	Vendim për lejimin e mjeteve financiare para xhepi	2
40.	Refuzohet kërkesa e Kryetarit të Sindikatës	1
41.	Vendim për ndalimin e diferencës në pagë	1
42.	Vendim për transferimin të përkohshëm	2
43.	Vërtetim për përvojen e punës të nëpunësve	13
44.	Vendim për përjashtim nga procedura e ankesave,shkak konflikt interesi	1
45.	Vendim për ndryshim dhe plotësim për Komisionin e Ankesave	1
46.	Vendim për aprovimin e Projektit të DKRS-së	1

47.	Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës pa pagesë, fushata zgjedhore	2
48.	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës	1
49.	Vendim për caktimin e zyrtarit për rintegrim për personat e riatdhesuar	1
50.	Vendim për refuzim të pushimit mjekësor me kompensim 70% të pagës	1
51.	Vendim për aprovimin e projektit të DKA-së	1
52.	Vendim për delegimin e përgjegjëseve	1
53.	Konkurse Publike	12
54.	Vendim për shpallje jo kompetent për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me ankesën e nëpunësit civil	1
55.	Vendim për kompensimin e punës jashtë orarit të punës në ditë të pushimit	1
	Totali	196

Gjatë kësaj periudhe janë përditësuar dosjet individuale të nëpunësve, si në formë fizike ashtu edhe në sistemin elektronik, duke siguruar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për secilin nëpunës.

Po ashtu, është siguruar që të gjithë nëpunësit të jenë të pajisur me kartela identifikuese [*përgjashtimisht mungesa e materialeve në disa raste*]. Për nëpunësit e sapo pranuar janë siguruar kartela të reja identifikuese, ndërsa për ata që nuk kanë qenë të pajisur ose që i kanë

humbur kartelat ekzistuese, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative dhe janë proceduar kërkesat për pajisje me kartela të reja.

Këto aktivitete janë realizuar me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt të sistemit elektronik të evidencës së vijueshmërisë në punë, i cili bazohet në përdorimin e kartelave identifikuese për regjistrimin e hyrje-daljeve të nëpunësve.

Gjithashtu, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me IKAP-in lidhur me organizimin dhe koordinimin e trajnimeve profesionale për nëpunësit. Ky bashkëpunim ka përfshirë trajnimet e planifikuara nga IKAP-i në kuadër të programit vjetor të ngritjes së kapaciteteve, si dhe trajnimet e propozuara sipas nevojave specifike të drejtorive përkatëse.

Në këtë drejtim, NjMBNj, identifikon nevojat për trajnim, ka koordinuar procesin e nominimit të pjesëmarrësve dhe ka siguruar pjesëmarrjen e nëpunësve në trajnimet përkatëse, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të performancës në ushtrimin e detyrave zyrtare.

Komisionet disiplinore kanë shqyrtuar dhe proceduar rastet e shkeljeve disiplinore të nëpunësve civilë dhe zyrtarëve të shërbimit publik, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Zyra e Prokurimit:

Gjatë periudhës janar–korrik 2026, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Deri në këtë fazë janë iniciuar gjithsej 53 aktivitete të prokurimit.

Aktivitetet

Procedura me vlerë minimale: 8 procedura të kontraktuara me vlerë totale 6,402.10 €.

Procedura të shërbimeve: 13 procedura; disa janë nënshkruar ndërsa të tjerat janë në proces. Vlera e shpalljes është 458,370.05 €. Rrjedha e procedurave paraqitet në raportin shoqërues në Excel.

Procedura të furnizimeve: 18 procedura; disa janë nënshkruar dhe disa janë në proces. Vlera totale e shpalljes është 879,273.80 €. Rrjedha e procedurave paraqitet në raportin shoqërues në Excel.

Procedura të punëve: 8 procedura; disa janë nënshkruar dhe disa janë në proces. Vlera e shpalljes është 1,508,642.52 €. Rrjedha e procedurave paraqitet në raportin shoqërues në Excel.

Ankesat

Për procedurat e shpallura gjatë vitit fiskal 2026 nuk është paraqitur asnjë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Deri më tani janë paraqitur vetëm dy ankesa pranë Autoritetit Kontraktues (A.K.), të cilat janë vlerësuar si të pabazuara.

Përfundim

Bazuar në aktivitetet e realizuara gjatë periudhës janar–korrik 2026, Zyra e Prokurimit ka përmbushur detyrat e saj në mënyrë profesionale dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi. Aktivitetet e iniciuara janë zhvilluar sipas planifikimit, ndërsa mungesa e ankesave në OSHP dëshmon për transparencën dhe korrektësinë e procedurave.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme:

Gjatë periudhës Janar–Maj 2026, Drejtoria e Administratës ka vazhduar angazhimin e saj në ofrimin e shërbimeve efikase dhe cilësore për qytetarët, duke siguruar funksionimin e rregullt të administratës komunale dhe zbatimin e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Fokusi kryesor i Drejtorisë gjatë kësaj periudhe ka qenë përmirësimi i shërbimeve administrative, menaxhimi i kërkesave të qytetarëve, avancimi i proceseve të punës dhe rritja e efikasitetit institucional. Përmes koordinimit të vazhdueshëm me sektorët përkatës, është arritur trajtimi dhe përfundimi me sukses i një numri të konsiderueshëm kërkesash dhe shërbimesh administrative.

Në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë janë iniciuar edhe procedura të ndryshme të prokurimit dhe tenderimit, ku një pjesë e tyre janë përfunduar me sukses, ndërsa të tjerat vazhdojnë të jenë në proces sipas planifikimeve dhe procedurave ligjore në fuqi.

Gjatë periudhës janar–maj 2026, në nivel komunal janë pranuar gjithsej **14 414 kërkesa** nga qytetarët. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuara, **10 602 kërkesa kanë qenë të drejtuara për Drejtorinë e Administratës**, të cilat janë trajtuar dhe përfunduar në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Numri i lartë i kërkesave të adresuara në Drejtorinë e Administratës dëshmon rolin e rëndësishëm të kësaj drejtorie në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të stafit për të siguruar shërbime efikase, profesionale dhe cilësore.

DAP KERKESAT	Janar	Shkurt	Mars	TM1	Prill	MAJ
Të pranuar	0	1	0	1	0	0
Në Proces	6	10	11	27	3	8
Miratuar	280	305	233	818	284	273
Refuzuar	0	0	0	0	0	0
Hedhur Poshtë	0	0	0	0	0	0
Pezulluar	0	0	0	0	0	0
Ceduar	0	0	0	0	0	0
Anuluar	4	5	3	12	2	3
Përfunduar	1960	1566	1825	5351	1937	1929
Totali	2250	1887	2072	6209	2226	2167
Totali për drejtoritë	2779	2600	3010	8389	3177	2848

Sa i përket Sektorit të Gjendjes Civile, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar një numër i konsiderueshëm i kërkesave dhe dokumenteve administrative. Në total janë lëshuar dhe përpunuar 11 716 **dokumente**, duke përfshirë certifikata dhe dokumente të tjera të gjendjes civile të kërkuara nga qytetarët.

Ky numër i lartë i dokumenteve të lëshuara pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të stafit për ofrimin e shërbimeve efikase, profesionale dhe në kohë për të gjithë qytetarët.

Lloji I dokumentit	Janar	Shkurt	Mars	TM1	Prill	MAJ
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	1041	782	929	2752	699	1035
Certifikatë lindje	456	333	491	1280	568	302
Certifikatë martese	288	222	225	735	241	193
Certifikatë vdekje	197	190	131	518	167	217
Aktvdekje	248	202	239	689	21	179
Certifikatë vendbanimi	198	176	226	600	271	148
Certifikatë të bashkësisë familjare	68	30	47	145	171	34
Certifikatë të gjendje martesore	9	11	4	24	59	12
Certifikatë shtetësie	23	43	23	89	3	20
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi	3	4	3	10	33	5
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës	20	20	22	62	0	28
Konfirmime / Vërtetime	9	6	13	28	8	6
Pranim Atësie	2	1	1	4	0	0
Deklarata për kthim te mbiemrit brenda 6 muajve	1	1	0	2	0	0

Procedura mbi 18 vjet regjistrim	2	2	6	10	7	7
Persona mbi 90 vjet	3	21	5	29	8	1
Përgjigje Gjykatave	0	4	3	7	2	0
Përgjigje divizionit të Pensioneve	5	5	8	18	5	15
Aplikim për fitim të shtetësisë	0		1	1	1	0
Aplikim për lirim të shtetësisë	2505	1989	2315	6809	2212	2140
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile dhe shërbim:				0		
Totali:	2250	2052	2377	6679	2264	2202
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda vendit :	0	0	0	0	0	0
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, jashtë vendit :	11	46	18	75	66	25
Martetat e lidhura dhe rishkrim martese:	9	0	16	25	2	4
Shkurorëzimet :	2	2	3	7	2	2
Martetat me element të huaj :	4	10	8	22	10	7
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda vendit :	5	0	4	9	3	5
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit:	1	2	6	9	42	2

Mjete jetese	97	61	45	203	0	25
Vendime për korrigjime në emra personal :	3	1	1	5	0	1
Vendime për ndërrime në emra personal :	0	0	1	1	0	0
Totali:	132	122	102	356	128	71

Raporti i Arkës

Sa i përket të hyrave vetanake, Drejtoria e Administratës ka kontribuar në realizimin e të hyrave komunale përmes ofrimit të shërbimeve administrative dhe lëshimit të dokumenteve të ndryshme për qytetarët. Gjatë periudhës janar–maj 2026 janë inkasuar gjithsej 12 591.5 €, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave financiare të komunës.

Departamenti	Pagesa per sherbim	Pagesa bankare	Total Pagesa
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	12239.5	352	12591.5

Sa i përket kërkesave për shfrytëzimin e veturave zyrtare, gjatë periudhës janar–maj 2026 është realizuar një menaxhim efikas dhe i koordinuar i tyre. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej **139** kërkesa për përdorimin e veturave zyrtare, ku 117 janë aprovuar dhe vetëm **22 kërkesa janë refuzuar** për shkak të pamundësisë së ofrimit të shërbimit në kohën e kërkuar ose për arsye të tjera organizative.

	JANAR	Shkurt	Mars	TM1	PRILL	MAJ	Totali
Kërkesat për përdorimin e veturave zyrtare	19	25	27	71	30	38	139
Të aprovuara	18	16	20	54	28	35	117
Të anuluar	1	9	7	17	2	3	22

Derivatet 2026

		Janar	Shkurt	Mars	TM1	Prill	Maj
Vetura	Targat	Litrat					
Hynday i20	06Z-03-10	30	75	0	105	35	0
Shkoda	06Z-01-10	79	?	PK	79	PK	PK

Shkoda	06Z-18-10	42	45	30	117	40	70
Shkoda	06Z-17-10	70	80	80	230	118	47
Toyota Prado	06Z-16-10	50	0	200	250	150	120
Shkoda	06Z-15-10	?	42	?	42	58	98
Hynday i30	06Z-19-10	40	30	37	107	38	35
Amarok	06Z-20-10	100	50	150	300	90	120
Amarok	06Z-21-10	50	80	100	230	50	100
Shkoll-kos	Shkollat	30		30	60	120	40
Mitsubish	06Z-06-10	0	100	100	200	50	35
Mitsubishi	06Z-13-10	0	0	?	0	0	96
Toyota Yaris	06Z-25-10	32	57	61	150	89	0

Toyota Yaris	06Z-26-10	89	0		89	0	?
Audi	06Z-29-10	48	43	97	188	120	0
yaris	06Z-30-10	AKSIDENT	?			0	0
Crafter	06Z-31-10	?	50	100	150	100	0
Mirmbajtje	Qyteti	130	0	100	230	90	0
Peugeot	06Z-33-10	0	50		50	0	40
Peugeot	6Z-32-10	33	44	44	121	0	0
BMË		100	134	57	291	162	0
Traktor	39		0	25	25	0	0
Xheneratori			0	40	40	0	0
Bageri I Vogel			0	40	40	0	0
CAT -966		215	230		445	0	0
Totali					3539		

ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË KOORDINATORES SË NJKDNJ-së

- **Raporti vjetor për monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe strategjive kombëtare për të drejtat e njeriut** - Koordinatorja e NJKDNJ-së, ka përgatitur raportin lidhur me monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe strategjive kombëtare për të drejtat e njeriut, të cilin e kanë pranuar nga Divizioni për të Drejtat e Njeriut (DDNJ) pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Qëllimi i raportit ka qenë mbledhja e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të sakta nga institucione të ndryshme komunale dhe rajonale, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe strategjive kombëtare për të drejtat e njeriut. (19 janar 2026)
- Koordinatorja ka përgatitë dhe dorëzuar Zyrës për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit raportin për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (2021–2025) dhe Planit të Veprimit (2024–2026) – Komuna e Kamenicës.
- **Njoftim për Platformën www.raportodiskriminimin.org** përmes publikimit në rrjetet sociale Koordinatorja e NJKDNJ-së ka njoftuar qytetarët sa i përket platformës www.raportodiskriminimin.org, e cila mundëson raportimin e rasteve të diskriminimit, përfshirë edhe martesat e hershme, në mënyrë konfidenciale. Kjo platformë është një mjet i rëndësishëm për qytetarët që të denoncojnë raste të tilla dhe për ne që të ndërmarrim veprime të duhura.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së, njëherit edhe Koordinatorja e Komitetit Lokal të Veprimit për RAE ka hartuar dhe dorëzuar raportin vjetor mbi zbatimin e Planit të Veprimit 2025–2026, bazuar në kornizën zyrtare të raportimit, duke pasqyruar aktivitetet, masat dhe veprimet e ndërmarra nga Komuna e Kamenicës për përmirësimin e gjendjes së komunitetit rom. Raportin ia ka dorëzuar Drejtorit

për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit (Referenca e bërë i përket raportit vjetor mbi zbatimin e Planit të Veprimit, ndërsa periudha e vlerësimit në këtë rast është janar–qershor 2026).

- **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down** - Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Kamenicës, në bashkëpunim me Institucionin Parashkollor “Filizat”, prindërit e fëmijëve që janë pjesë e këtij institucioni, si dhe me mbështetjen profesionale të logopedes Lineta Leci, ka organizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse dhe gjithëpërfshirëse.

Fëmijët, së bashku me edukatorët, morën pjesë në aktivitete kreative si vizatime, punime të ndryshme, dekorime me çorape shumëngjyreshe si dhe ngjyrosje të duarve me ngjyrat blu dhe të verdhë, të cilat simbolizojnë këtë ditë dhe mesazhin për pranimin e dallimeve dhe barazinë.

“Përmes këtyre aktiviteteve, edukatorët bashkë me fëmijët kanë përcjellë mesazhe të fuqishme për dashuri, pranueshmëri dhe respekt për secilin fëmijë, pa dallim,” u theksua gjatë organizimit.

Një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e këtyre aktiviteteve kanë pasur edhe prindërit, të cilët jo vetëm që kanë mbështetur organizimin me përkushtim dhe pjesëmarrje aktive, por kanë kontribuar edhe financiarisht, duke dëshmuar bashkëpunim të ngushtë me institucionin dhe përkushtim të sinqertë për mirëqenien dhe përfshirjen e fëmijëve të tyre në aktivitete me vlera edukative dhe sociale.

Në këtë kuadër, Koordinatorja e NJKDNJ-së, Nazmije Demolli Kastrati, ka përgatitur “21 slogane për 21 Mars”, ku secili slogan përcjell mesazhe të fuqishme për përfshirje, respekt, dinjitet dhe të drejta të barabarta për personat me Sindromën Doën. Këto slogane janë vendosur në hapësirat e jashtme të Shtëpisë së Kulturës “Isa Kastrati” në Kamenicë, bashkë me Zyrtaren për Barazi Gjinore, Kosovare

Maroca Berisha, me qëllim që të jenë sa më të dukshme për qytetarët dhe të shërbejnë si mesazhe ndërgjegjësuere për pranimin e diversitetit dhe promovimin e barazisë në shoqëri.

Po ashtu, janë shpërndarë fletëpalosje informuese për qytetarët, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit, informimit dhe promovimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe pa paragjykime.

Në fund, Koordinatorja e NJKDNJ-së theksoi se mesazhi i kësaj dite është që çdo individ, pavarësisht dallimeve, meriton respekt, mundësi të barabarta dhe përfshirje të plotë në shoqëri, duke ndërtuar kështu një komunitet më të drejtë dhe më njerëzor për të gjithë.

- **Fuqizimi i Bashkëpunimit Institucional për Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore në Sektorin e Sigurisë.** Koordinatorja e NJKDNJ-së priti në takim përfaqësuese nga Ministria e Mbrojtjes, ku u diskutua për fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitutional në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, si dhe u prezantua fushata e rekrutimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).
- **2 Prilli – Dita Botërore e Autizmit** - Në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit është realizuar një aktivitet ndërgjegjësuere me qytetarë, ku janë shpërndarë materiale informuese mbi autizmin me qëllim rritjen e vetëdijes dhe promovimin e përfshirjes së personave me autizëm në shoqëri.
- **Dita Ndërkombëtare e Romëve** - Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, Njësia për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere me qytetarë, duke shpërndarë materiale informuese me qëllim promovimin e barazisë, respektit dhe përfshirjes së plotë të komunitetit rom në jetën shoqërore.

- Takim pune për funksionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës - Koordinatorja e NJKDNJ-së, ka zhvilluar një takim pune me Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe përfaqësues të kësaj drejtorie, ku është diskutuar rëndësia e funksionalizimit të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2022. Në takim u trajtuan hapat konkretë për organizimin e mbledhjes së parë konstituive dhe koordinimi institucional për funksionalizimin e plotë të ekipit.

- **Dita Botërore e Librit** - Në kuadër të Ditës Botërore të Librit është realizuar një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për rëndësinë e leximit dhe rolin e librit në zhvillimin e dijes dhe kulturës. Përmes shpërndarjes së informacionit, është promovuar leximi si mjet për zhvillimin e mendimit kritik, uljen e stresit dhe zgjerimin e njohurive. Gjithashtu është theksuar rëndësia historike e kësaj date dhe kontributi i figurave të shquara të letërsisë botërore dhe shqiptare.

- **Kontribut në përgatitjen e raportit vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi për vitin 2025** - Në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM), është pranuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit lidhur me angazhimet institucionale në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2025. Me këtë rast, Koordinatorja e NJKDNJ-së, njëherit edhe zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimi ka plotësuar dhe dorëzuar pyetësorin përkatës, duke kontribuar në përgatitjen e raportit vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

- **Në kuadër të Ditës ndërkombëtare të familjes**, Koordinatorja e NJKDNJ-së ka përgaditur një videomesazh për rëndësinë e familjes dhe gjatë kësaj jave ka vizituar disa shkolla dhe iu ka shpërndarë nxënësve materiale sensibilizuese për rëndësinë e familjes ku thekson që mesazhi kryesor i kësaj fushate është: “Mbrojtja fillon në familje”.

- **Me rastin e 31 Maji – Dita Ndërkombëtare Kundër Duhanit**, Koordinatorja e NJKDNJ-së, ka përgatitur dhe shpërndarë materiale promovuese dhe vetëdijesuese kundër pirjes së duhanit, me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit qytetar për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e efekteve të dëmshme që shkakton duhani.

PJESËMARRJE NË TAKIME, TRYEZA DISKUTIMESH E PROGRAME TË NDRYSHME

- **Vizitë zyrtare dhe takim koordinues në Qendrën për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan.** Koordinatorja e NJKDNJ-së realizoi vizitë zyrtare në Qendrën për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan, ku u prit nga drejtoresha e qendrës, znj. Nazife Jonuzi, së bashku me stafin profesional. Gjatë takimit u diskutua bashkëpunimi dhe koordinimi institucional ndërmjet Komunës së Kamenicës, përkatësisht NJKDNJ-së, dhe QMRGF “Liria”, me fokus në rolet dhe përgjegjësitë përkatëse në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës, si dhe në avancimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- **Koordinatorja e NJKDNJ-së në cilësinë e Antares së Komisionit Komunal për Riintegrim (KKR), në kuadër të Komunës së Kamenicës, ka marrë pjesë në takimin e KKR-së.** Duke vepruar konform nenit 44 të Rregullores (QRK) Nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe pikës 2 të Vendimit Sh.02 Nr.6354 të datës 18.03.2025, shqyrtuam dhe vendosëm në lidhje me kërkesën respektive.

- **Koordinatorja e Njesisë për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) në Kamenicë mori pjesë në punëtorinë me temë “Nxitja e pjesëmarrjes së grave në Subvencione, Dëgjime Publike dhe Këshilla Lokal”, e organizuar në kuadër të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore.**
- Koordinatorja e NJKDNJ-së njëherit edhe Koordinatore e Komitetit Lokal për komunitetet RAE në Komunën e Kamenicës, mori pjesë në trajnimin dyditor “Kuptimi dhe adresimi i antigjipsizmit”, të organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Këshillin e Evropës. Gjatë trajnimit u trajtuan tema mbi kuptimin, identifikimin dhe adresimin e antigjipsizmit, si dhe u prezantuan praktika dhe përvoja relevante.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së, njëherazi edhe Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, është ftuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) pranë Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për të dhënë mendimet e saj profesionale dhe për të ndarë përvojën e saj lidhur me: Plotësimin e pyetësorit për intervistë me zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal, me qëllim të mbledhjes së të dhënave dhe propozimeve për riorganizimin e njësive përkatëse, si dhe përmirësimin e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së mori pjesë në një takim konsultues për fuqizimin e shërbimeve sociale dhe të kujdesit në Komunën e Kamenicës, ku u diskutua gjendja aktuale dhe nevojat për përmirësim të këtyre shërbimeve.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së mori pjesë në Forumin e 3-të të Shkëmbimit për Qeverisje të Hapur Lokale dhe Inovacione Demokratike, ku prezantoi praktikën e Komunës së Kamenicës në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare.

- Koordinatorja e NJKDNJ-së ka marrë pjesë në një takim konsultativ të organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, në kuadër të mandatit ligjor për mbrojtje nga diskriminimi. Takimi kishte për qëllim diskutimin dhe standardizimin e detyrave të mekanizmave institucionalë në nivel qendror dhe lokal, me synim rritjen e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.
- Koordinatorja e NJKDNJ-së priti në takim Vjosa Emini, Asistente e Programit pranë OSBE-së. Gjatë takimit u diskutua lidhur me aktivitetet në kuadër të Planit të Veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Kamenicës. U theksua rëndësia e koordinimit të aktiviteteve, identifikimit të prioritetëve dhe forcimit të bashkëpunimit institucional për zbatimin sa më efektiv të planit.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:

Përgatitja e Planifikimit të punëve për vitin 2026;

- Që në fillim të muajit Janar, DBPZHR për vitin 2026, ka bërë planifikimin e të gjitha punëve dhe projekteve që duhet të realizohen në gjashtë mujorin e parë Janar – Qershor dhe gjashtëmujorin e dytë korrik – dhjetor. Gjatë këtij gjashtë mujori të parë, punët që janë kryer në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ne po i paraqesim sipas radhës që janë kryer.

I gjithë raporti i punës në pika të shkurtra për gjashtë mujorin e parë Janar – Qershor 2026, është i paraqitur si më poshtë.

Fazat e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione nga MBPZHR. – AZHB. – ja;

Aplikimi për subvencionim, të Qumështit /lit. sipas klasave, majmëri të viçave dhe therjet e raportuara të viçave në kuadër të MBPZHR. – AZHB.;

- Afatin e aplikimit për subvencionim të qumështit për litër për 6M -2 / 2025, majmëri të viçave dhe therjet e raportuara të viçave nga MBPZHR. / AZHB – ja, e kemi pasur që nga data 19.01.2026 dhe ka zgjatur deri më datë 18.02.2026.

Subvencionimi i qumështit bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrata me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë edhe atë sipas kategorive që po i japim më poshtë :

1. Ekstra Klasë - 0.07 €./ litër.

2. Klasa e parë - 0.04 €./ litër.

3. Klasa e dytë - 0.02 €./ litër.

- Më pjesën si më poshtë në formë tabelore po i paraqesim të gjitha aplikimet:

Nr.	Emërtimi	Nr. Aplikuesve	Sasia në / lit.të dorëzuar, nr. i viçave etj.
1	Qumësht për/ lit. Sipas klasës;	72	1,050,354 / litra
2	Majmëri të viçave;	13	277 / krerë
3	Therje të viçave;	1	41 / krerë

Fazat e Aplikimit për Subvencionim të Qumështit nga drejtoria e bujqësisë/Komuna, për 6 M – 2 (korrik – dhjetor)-2025;

- Afatin e aplikimit për subvencionim të qumështit për litër për 6 M -2 / 2025 (korrik – dhjetor), e kemi pasur që nga data 04.02.2026 dhe ka zgjatur deri më datë 06.03.2026.

Në këtë 6 M – 2 / 2025 numrin e aplikuesve dhe përfituesve po i paraqesim përmes tabelës si më poshtë:

Nr.	Emërtimi;	Nr. Aplikuesve;	Sasia e lit. e Aplikuar;	Nr. Përfituesve;	Sasia e litrave për Pagesë/lit.;	Çmimi 0.05€/lit .;	Gjithsejt për Pagesë në €.;
1	6M -2 / 2025.	82	1,084,854	82	888,857	0.05 € / lit.	44,442.⁸⁵ €.

Mbajtja e temave trajnuese nga zyrtarët e Drejtorisë së bujqësisë;

- Gjatë gjashtë muorit të parë, Janar – Qershor, janë mbajtur temat trajnuese sipas planifikimeve të zyrtarëve të bujqësisë, për sektor të ndryshëm. Të gjitha temat që janë mbajtur, ne po i paraqesim përmes tabelës si më poshtë:

- **Temat trajnuese të mbajtura nga zyrtarët e bujqësisë, për sektor të ndryshëm /2026.**

Nr.	Temat trajnuese;	Sektori;	Emri & Mbiemri i Zyrtarit;	Data e mbajtjes;
1	„ Përgatitja e leheve dhe përzgjedhja e farërave për mbjellje ” ;	Perimekulturë;	Almedina KryeziuSpahiu;	06.02.2026.
2	„ Kultivimi i dredhëzës për prodhim, (pastrimi i sythave, plehërimi, mbrojtja);	Pemëtari/ Pemë manore;	Bektesh Dërmaku;	03.03.2026.

3	„ Përmirësimi i ushqimit të kafshëve ”;	Blegëtori;	Qëndrim Dërmaku;	06.03.2026.
4	„ Faza e ndërrimit të fidanëve nga modulet në Sera ”;	Perimekulturë;	Almedina KryeziuSpahiu;	02.04.2026.
5	„ Seleksionimi i viçave femra për mbarështim (vlerësimi i eksterierit) ”;	Blegëtori;	Bektesh Dërmaku;	03.04.2026.
6	„ Plehërimi dhe ri-plehërimi i kulturës së grurit ” ;	Lavërtari;	Kaltrina Kadriji;	15.04.2026.
7	„ Menaxhimi i kullotave ”;	Blegëtori;	Qëndrim Dërmaku;	16.04.2026.
8	„ Të ushqyerit e perimeve në serrë me plehra kristalor(starter 20:20:20, finisher)”;	Perimekulturë;	Bektesh Dërmaku;	21.04.2026.
9	„ Mbrojtja e kulturave lavërtare ”;	Lavërtari;	Almedina KryeziuSpahiu;	27.04.2026.
10	„ Ngritja e stallave me infrastrukturë përcjellëse (Lopë qumështore dhe viçave për majmëri , sistemet e mbarështimit)”;	Blegëtori;	Bektesh Dërmaku;	13.05.2026.
11	„ Ujitja e perimeve në sera dhe përdorimi i plehrave kristalorë ”;	Perimekulturë;	Kaltrina Kadriji;	14.05.2026.

Organizimi dhe mbajtja e sesioneve informuese organizuar nga DBPZHR.;

Gjatë këtij gjashtë mujori të parë, drejtoria e bujqësisë ka organizuar dhe mbajtur disa sesione informuese dhe tema trajnuese me profesor të lëmive ndryshme, që do ti paraqesim në pika të shkurtra si më poshtë;

Më datë 18.02.2026, është mbajtur sesioni informues i radhës me grupin punues për projektin „ Grumbullimi (deponia) i mbeturinave të gjelbërta ” me fermerët e komunës tonë.

Më datë 29.04.2026, është mbajtur sesioni informues me fermerët e komunës tonë, me titull „ Kompostimi në komunitet, vetëdijesimi i fermerëve në përdorimin e drejtë të plehrave dhe pesticideve ” . Prezantimin e ka bere prof. Bekim Ermeni

Më datë 18.05.2026 është mbajtur tema trajnuese për sektorin e Pemëtarisë me grupin e fermerëve kultivues të arrës, mollës, kumbullës, të prezantuar nga prof. Besim Sahiti dhe interesimi i fermerëve ishte në nivel të duhur. Tema trajnuese ishte: „ Teknologjia e kultivimit të arrës ”.

- Gjatë këtij gjashtë mujori të parë kemi pasur disa kërkesa nga palët e komunës tonë, për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore në atë ndërtimore, si dha nga pyjore në atë bujqësore, siç janë të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emërtimi;	Kultura;	Ndërrimi në;	Nr. i tyre:
1	Ri- destinimi i tokës nga:	Kullosë;	Ndërtimore;	1
2	Ri- destinimi i tokës nga:	Bujqësore;	Ndërtimore;	9
			Gjithsej:	10

Më datë 10.03.2026, pas pranimi të kërkesës nga pala për ndërrim të destinimit të tokës nga pyjore në atë bujqësore, në cilësi të komisionit kemi dalur në vend të ngjarjes për të parë gjendjen faktike të ngastrës që është bënë ndërrimi i kulturës.

Vlerësimi i dëmeve në teren sipas kërkesave të fermerëve;

Në kuadër të vlerësimeve të dëmeve tek fermerët e komunës tonë, këtë gjashtëmujor të parë kemi pasur disa kërkesa të fermerëve për dëmet që ju janë shkaktuar nga erërat e forta, vërshimet e ujit etj.

Më datë 13.05.2026 me kërkesë të palës kemi dal në teren për të parë dëmin e shkaktuar në ngastrën e mbjellë me pishë. Pasi që e kemi shikuar në vend të ngjarjes ngastrën me pishë, vërejtëm se pjesa më e madhe ishte dëmtuar nga sëmundja, kurse sa i përket dëmit të shkaktuar nga vërshimi i ujit nga lumi, nuk ishte ndonjë dëmtim i konsiderueshëm.

Më datë 19.05.2026 me kërkesë të palës kemi dal në teren për të parë dëmin e shkaktuar në ngastrën e cila ishte e ngritur serra . Pas erërave të forta që kemi pasur në komunën tonë, fermerit ju është shkaktuar dëmi në llastikun (folija) që ishte dëmtuar në masë të konsiderueshme.

Projektet e planifikuara nga DBPZHR.;

- Gjatë këtij gjashtë mujori të parë, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektet sipas planifikimeve, që ne po i paraqesim përmes tabelës si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i projekteve	Projekte të realizuara;
1	Qumësht për litër 0.05 €. / lit. - 6 M / 2 (korrik – dhjetor - 2025);	Nga MBPZHR.;

2	Qumësht për litër 0.05 €. / lit. - 6 M / 2 (korrik – dhjetor - 2025);	Nga DBPZHR. /Komuna;
3	Trajtimi i qeneve endacak;	Është në proces;

- Gjatë gjashtëmujorit të parë në kuadër të projekteve të planifikuara, kemi edhe projektin „ Trajtimi i qeneve endacak ” dhe është duke u përcjellë puna e trajtimit të qenëve nga menaxheri i kontratës, vizitë qendrës së trajtimit, daljet në teren etj.
Shkollat tona në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit kanë organizuar aktivitete të ndryshme për shënimin e datave të rëndësishme kombëtare, historike, kulturore dhe ndërkombëtare. Përmes orëve tematike, akademive përkujtimore, programeve kulturore dhe aktiviteteve sensibilizuese, nxënësit janë njohur me vlerat historike, kulturore dhe qytetare. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e identitetit kombëtar, edukimit qytetar dhe ndërgjegjësimin për çështje me rëndësi shoqërore.

Me qëllim të pasurimit të përvojës mësimore dhe lidhjes së njohurive teorike me praktikën, shkollat kanë organizuar ekskursione dhe vizita edukative në institucione arsimore, kulturore, historike, shkencore dhe ekonomike. Nxënësit kanë pasur mundësi të njihen nga

afër me trashëgiminë kulturore, monumentet historike, institucionet publike dhe proceset e ndryshme të punës. Këto aktivitete kanë ndihmuar në zgjerimin e njohurive, zhvillimin e aftësive sociale dhe rritjen e motivimit për të mësuar.

Një prej aktiviteteve të rëndësishë së veçantë është organizimi i Ceremonisë së Diplomimit të Maturantëve ku këtë vit në këtë ceremoni ka pasur një interesim tejet të lartë të pjesëmarrjes duke bërë një aktivitet shumë kreativ dhe atraktiv për nxënësit, stafin dhe prindërit.

Një rast tjetër shumë i veçantë me nxënës është edhe realizimi i EuroTripit për Maturantët më të mirë të Komunës sonë, ku 24 nxënës Maturantë kanë zhvilluar një vizitë 3 ditore në Stamboll vizitë kjo e cila ka pas një ndikim tejet pozitiv edhe për nxënës të cilët janë në ShFMU dhe ShFML.

- Kremta e Pavarësisë
- Takime dhe bashkëkoordinim me Inspektoratin e Arsimit në Gjilan
- Krijim i hapësirave të sigurta për nxënës
- Bashkëpunimi me donator
- Inagurimi i Busteve të Heronjëve Metush Krasniqi dhe Sejdi Kryeziu
- Organizimi i garave
- Hartimi i planeve nga kolegjiuemeve
- Realizimi i Ekskursionit të Semi Maturantëve
- Realizimi i Euro Trip-it
- Rreth 7 mij libra për shkollat tona
- Festa e Abetarës 2026
- Kupa e Anamoravës 2026
- Dita e Çlirimit me nxënës

Nga muaji Mars deri më tani në Qershor kemi realizuar rekord procedura të prokurimit si asnjë vit më parë e ato janë:

Rendor i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
1	02100000-5	Furnizim me dru	23.03.2026
2	02100000-5	Furnizim me Pelet	24.03.2026
3	15884000-8	Furnizim me ushqim te shendetshem ne çerdhe	27.03.2026
4	28811500-5	Furnizim me material didaktik	29.06.2026
5	36520000-2	Furnizim me lodra per femijet ne çerdhe	05.05.2026
6	21120000-0	Furnizim me paketim te ushqimit per kuzhine	04.05.2026
7	17215400-6	Furnizim me tepih,perde dhe roleta per shkolla	06.04.2026
8	24521600-8	Furnizim me material higjienik per shkolla	02.06.2026
9	17221200-9	Furnizim me çanta shkollore	08.05.2026

10	28415320-3	Furnizim me markera	22.06.2026
11	36153110-2	Furnizim me rekuizita sportive	29.05.2026
12	18115000-8	Furnizim me uniforma - shkollat e mesme	23.04.2026
13	26212200-9	Furnizim me pajisje dhe ene per kuzhinen popullore	15.05.2026
14	22111000-1	Furnizim me libra	12.05.2026
15	15884000-8	Furnizim me materiale ushqimore per shkolla	27.04.2026

Një prej aktiviteteve tejet të rëndësishme që jemi në planifikim e sipër për të realizuar është punëtoria shkencore me fokus realizimin e mësimit tërditor në tri shkolla të komunës sonë sipas strategjisë së hartuar nga ekipi i ekspertëve, ku kjo punëtori me pjesëmarrje të ekspertëve vendas do të mbahet më datë 25.06.2026 e cila pritet të jap një ndihmesë të madhe në raport me implementimin e strategjisë të mësimit tërditor në këto shkolla.

Sfidat:

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Arsimit është përballur me një sërë sfidash dhe problemesh që kanë ndikuar në funksionimin dhe zhvillimin e procesit edukativo-arsimor. Identifikimi i këtyre sfidave është i rëndësishëm për planifikimin e masave dhe aktiviteteve që synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit dhe stafin arsimor.

Një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet mungesa e kuadrit profesional në disa lëndë mësimore, veçanërisht në shkencat natyrore, teknologji informative, matematikë dhe gjuhë gjermane. Po ashtu sfida tjetër është numri i madh i kërkesave për pushim me pagesë si raste të smundjeve dhe kjo shkakton humbje të lartë buxhetore. Vështirësitë në sigurimin e stafit të kualifikuar kanë ndikuar në organizimin e procesit mësimor dhe, në raste të caktuara, kanë kërkuar angazhimin e zëvendësuesve ose riorganizimin e ngarkesës mësimore. DKA ka ndërmarrë hapa për plotësimin e vendeve të lira përmes procedurave të rekrutimit të menjëhershëm në raste e paraqitura.

Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve paraqet një sfida të rëndësishme për sistemin arsimor në komunën tonë. Kjo situatë ndërlihet kryesisht me lëvizjet demografike, migrimin e familjeve dhe uljen e natalitetit.

Në disa shkolla vazhdojnë të ekzistojnë nevoja për investime infrastrukturore, përfshirë renovimin e objekteve si IP “Filizat”, ShFMU “Dëshmorët e Kombit”, IAAP “Andrea Durrsaku”, përmirësimin e sistemeve të ngrohjes, rregullimin e hapësirave sanitare, pajisjen me inventar dhe modernizimin e kabineteve mësimore. Gjithashtu, nevojitet përmirësimi i kushteve të sigurisë dhe krijimi i hapësirave më funksionale për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

AKTIVITETET I PARAPARË	REZULTATET E ARRITURA	KOHA E FILLIMIT	A ËSHTË MBYLLUR AKTIVITI?	PERSONI/AT PËRGJEGJËS	MBËSHTETJA E NEVOJITUR
Mbikëqyrja e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me menaxhmentin e QKMF-së dhe akterët e tjerë relevantë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase në kujdesin parësor-shëndetësor për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës pa dallim, përkatësisht, realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së; - Takim me Drejtorin e QKMF-së në lidhje me diskutimin rreth Projektit “Ndërtimi i objektit të QKMF-së; - Takim konsultativ me Njësinë e Stomatologjisë në lidhje me administrimin e sfidave dhe vështirësive të kësaj Njësie si dhe çështjen e riorganizimit të orarit për ofrimin e shërbimeve stomatologjike;	Janar-Qershor 2026	/	1.Dr.Besart Kryeziu 2. Dr.Latif Sylaj 3.Këshilli Drejtues i QKMF-së	Bashkëpunimi ndër-kolegial

	- Takim konsultativ me Njësinë e Laboratorit, në lidhje me administrimin e sfidave dhe vështirësive të kësaj Njësie, paisjet laboratorike funksionale si dhe diktatimi mbi Kërkesat e parashtruara të kësaj Njësie për furnizim me aparatura të tjera sipas kërkesave specifike të kësaj Njësie; - Takim me Udhëheqësit e Njësive të QKMF-së, me qëllim të diskutimit të riorganizimit të orarit të punës në QKMF dhe njësitë e saj; - Pranimi dhe shqyrtimi i Kërkesës për furnizim me aparate laboratorike në QKMF-Kamenicë dhe QMF-Roganë, si dhe planifikimi i tyre në Planin e Prokurimit për vitin 2026; - Vizitë në AMF Strezoc, Krilevë dhe QMF-Hogosht, në funksion të shqyrtimit dhe vendosjes të Kërkesës së Policisë, për dhënien në shfrytëzim;				
--	---	--	--	--	--

	- Takim me Infermieret në QKMF-në lidhje me administrimin e kërkesave të tyre rreth ndryshimit të orarit të ofrimit të shërbimeve; - Takim konsultativ me Udhëqësen e Administratës në QKMF, në lidhje me kompetencën për shqyrtim dhe vendosje në Kërkesat: 1. Nr.ref. 05/3.06 KA/112/2026 nga Policia dhe 2. Sh.02 Nr.6477 të datës 12.03.2026 nga Shoqata Humanitare Koretini; - Hartimi i Kërkesës Nr.14/2026 për Transferimin e lëndës tek Organi Kompetent, përkatësisht, transferimi i dy (2) Kërkesave (Kërkesa e Policisë dhe e Shoqatës Humanitare Koretini), kërkesë e parashtruar pranë QKMF-së; - Takim dhe koordinim i vazhdueshëm me Drejtorin e QKMF-së, në lidhje me çështjen e mbylljes së AMF-ve të cilat janë jo-funksionale;				
--	--	--	--	--	--

	- Takim me Udhëheqësin e Barnatores së QKMF-së MrPh.Gazmend Kryeziu, në lidhje me plotësim-ndryshimin e Listës esenciale të barnave, konform kërkesave të pacientëve, si dhe përpilimin e një databaze digjitale për pacientët që furnizohen me barna;				
Mbikëqyrja e Qendrës për Punë Sociale dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me Drejtorin e QPS-së, Udhëheqësen e Shërbimeve Sociale dhe Udhëheqësin e Asistencës Sociale, në me qëllim të ofrimit të shërbimeve efikase sociale, familjare dhe të asistencës sociale, në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Kamenicës, rrjedhimisht realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së; - Hartimi i Kërkesës Nr.11/2026 për sigurimin e një patrolle të policisë në oborrin e QPS-së, për realizimin e shpërndarjes së 127 pakove ushqimore, si donacion Chatar Chairity;	Janar- Qershor 2026	/	1. Dr.Besart Kryeziu 2. Rifat Hajdari	Bashkëpunimi ndër-kolegial

	- Takim pune me Drejtorin e QPS-së dhe Udhëheqësit e Njësive në lidhje me çështjen e renovimit të objektit të QPS-së, si dhe sigurimin e një veture për nevojat e QPS-së dhe Drejtorisë në përgjithësi.				
Mbikëqyrja e Shtëpisë së Komunitetit në Kamenicë dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me Udhëheqësin e SHKK-së, në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuar mendore – ngecje në zhvillim mendor, sipas kërkesave të parashtruara nga organet përkatëse; - Shqyrtimi dhe vendosja në Kërkesat e parashtruara për vazhdimin e qëndrimit të klientëve-rezidentëve në ShKK, rrjedhimisht, ofrimi i Pëlqimeve për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në këtë institucion.	Janar-Qershor 2026	/	1. Dr.Besart Kryeziu 2. Hajdin Krivaqa 3.Paneli për Strehim Rezidencial	Bashkëpunim ndër-institucional
Bashkëpunimi me Zyrën e Kryetarit, Kuvendin Komunal	-Takime pune me Kryetarin e Komunës, Nënkryetaren e Komunës, Shefin e Kabinetit, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Bordin e Drejtorëve etj;	Janar-Qershor 2026	/	1. Dr.Besart Kryeziu	Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, Nënkryetaren e Komunës, Drejtorët

dhe Drejtoritë e tjera në kuadër të komunës	-Pjesëmarrje në seancat e Kuvendit Komunal; -Hartimi i Kërkesës Nr.08/2026 për Rekrutimin e tre (3) Mjekëve të Përgjithshëm, kërkesë e parashtruar pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; -Hartimi i Kërkesës për Rekrutimin e një (1) Specialisti të Radiologjisë në QKMF, pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; -Hartimi dhe procedimi i Planit të Prokurimit të DShMS-së për vitin 2026, pranë Zyrës së Prokurimit; -Takim me administratën e DShMS-së në lidhje me hartimin e Planit të Punës së DShMS-së për vitin 2026, në funksion të përmbushjes së Kërkesës së datës 09.03.2026 nga Zyra e Kryetarit; -Pranimi dhe shqyrtimi i Kërkesës Nr.Ref. 03/3.06KA/112/2026 nga Policia e Kosovës, në lidhje me shfrytëzimin/qasjen në objektet e AMF-ve, në zonat periferike; -Pranimi dhe shqyrtimi i Kërkesës Sh.02 Nr.6477 të datës 12.03.2026 e parashtruar nga				e Drejtorive, Kryesuesen e Kuvendit Komunal, MMPHI, si dhe akterët e tjerë relevantë
---	--	--	--	--	--

	Shoqata Humanitare Koretini, me qëllim të shfrytëzimit të objektit nga kjo shoqatë; -Takim me administratën e DShMS-së dhe zyrtaren financiare, me qëllim të diskutimit rreth obligimeve të Komunës, përkatësisht DShMS-së, konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Sh.02 Nr.31085 të datës 25.09.2024 për Bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i Kuzhinës Qendrore”; -Hartimi i Kërkesës për përshpejtimin e procedurave ligjore për paisje me kushte ndërtimore në kuadër të projektit “Ndërtimi i objektit të QKMF-së”; -Takim pune me Drejtorin e Urbanizmit dhe administrimi i Projektit konceptual (kopja II) të objektit të QKMF-së, Sh.07 Nr.9291 të datës 10.04.2026; -Takim pune me përfaqësuesit e Drejtorisë për Investime Kapitale, me qëllim të shqyrtimit të mundësive për Renovimin e objektit ekzistues të QPS-së;				
--	--	--	--	--	--

	-Takim me Drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta – Projektit të Kontrollave Sistematike të nxënësve në aspektin e përgjithshëm shëndetësor; -Takim me Koordinatorin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, rreth funksionalizimit të Ekipit për të drejtat e fëmijës, si dhe shqyrtimi i aktiviteteve dhe objektivave të cilat janë të parapara në Planin e Punës së këtij ekipi.				
Informata dhe sqarime për Aplikim për Ndihmë financiare	-Ofrimi i informatave për palë dhe asistencës për aplikim për ndihmë financiare, e cila ndahet nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve nga lëmi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, i cili vepron pranë ZKA-së.	Janar-Qershor 2026	/	1. Dr.Besart Kryeziu 2. Stafi i DShMS-së 3.Komisioni	Bashkëpunimi me stafin e DShMS-së
Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), AQH-në	Implementimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2024 – Bashkë Pagesat për Shërbimet Shëndetësore, si dhe informimi i Administratës së QKMF-së për Udhëzimin në fjalë; - Hartimi i Kërkesës 07/2026, për largimin e Auto-Amulantave nga oborri i QKMF-së, e	Janar-Qershor 2026	/	1. Dr.Besart Kryeziu 2. Dr.Latif Sylaj	Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional

	parashtruar pranë Ministrisë së Shëndetësisë – Komuna e Prishtinës dhe QKMF-Prishtinë; - Koordinimi dhe bashkëpunimi me njësitë e DShMS-së për dhënien e propozimeve në Projekt Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale; - Hartimi i Kërkesës Nr.05/2026 për Ministrin e Shëndetësisë, në lidhje me Projektin e Objektivit të QKMF-Shtime; - Pjesëmarrje në lidhje me planifikimin dhe implementimin e shërbimeve të Kujdesit Primar Shëndetësor si dhe Modulet e organizuara nga AQH-ja;				
Bashkëpunim me Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ)	-Koordinimi dhe bashkëpunimi i rregullt i njësive të DShMS-së me Ministrinë; - Mbikëqyrje e implementimit të pilotimit të skemës sociale sipas ligjit të ri, përmes sistemit elektronik e-Kosova.	Janar-Qershor 2026	/	1.Dr.Besart Kryeziu 2. Sektori i Asistencës Sociale	Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional

Organizimi i kampanjave/fushatave senzibilizuese	Shënimi i ditëve botërore nga ekipa mjekësore e QKMF-së, sipas Kalendarit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh),	Janar-Qershor 2026	/	1.Dr.Besart Kryeziu 2. Dr.Latif Sylaj	Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional
Ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror	Në koordinim me stafin e DShMS-së, në mënyrë kontinuele i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në kuadrin e kompetencave tona, në funksion të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në realizimin e misionit dhe objektivave të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Hartimi i akteve juridike të cilat dalin nga fushëveprimtaria e drejtorisë në bazë të procedurave të përcaktuara dhe sipas legjislacionit në fuqi, e të cilat janë si në vijim: 1. Planifikimi i stafit; 2. Hartime të vendimeve; 3. Shqyrtimi i kërkesave; 4. Formimi i Komisioneve; 5. Inicimi i procedurave të ndryshme; 6. Adiministrimi dhe përpunimi i lëndëve për pranimin e donacioneve;	Janar - Qershor 2026	/	1.Dr.Besart Kryeziu	Bashkëpunim me stafin e DShMS-së

	7. Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit; 8. Implementimi i Rekomandimeve nga Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorës Kombëtare kundër Dhunës në familje, e cila i është drejtuar Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës; 8. Krijimi i Databazës së të dhënave nga Kontrollat sistematike të vitit të kaluar dhe përditësimi me të dhënat të cilat do ti administrojmë nga ky projekt; - Takim me stafin e administratës së DShMS-së dhe zyrtaren financiare për hartimin e Planit të Prokurimit për vitin 2026; - Takim me stafin e administratës së DShMS-së dhe zyrtaren financiare për hartimin e Planit të Shpenzimeve të buxhetit të DShMS-së dhe njërive të saja për vitin 2026; - Hartimi i Ftesës Publik Sh.04 Nr.9789 të datës 15.04.2026 për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve;				
--	---	--	--	--	--

	- Hartimi i përgjigjes në Kërkesën e parashtruar nga pala S.S; - Hartimi i përgjigjes në Kërkesën e parashtruar nga Udhëheqësi i Njesisë së Stomatologjisë në lidhje me çështjen/Kërkesën për servisimin e Aparaturës stomatologjike; - Hartimi i përgjigjes në Kërkesën e parashtruar nga Koordinatorja për mbrotjen e të drejtave të njeriut, në lidhje me çështjen e funksionalizimit të Ekipes për të drejtat e fëmijëve; - Pranimi dhe shqyrtimi i shkresës Nr.248/2026 të datës 17.04.2026 nga Ministria për Punë, Familje dhe vlerat e Luftës Çlirimtare, me qëllim të realizimit të disa prioriteteve dhe mundësive të komunave; - Hartimi i Kërkesës Nr.18/2026 Sh.01 Nr.10985 të datës 27.04.2026 për proceçim të mëtejme lidhur me institucionet shëndetësore jofunksionale në Komunën e Kamenicës;				
--	--	--	--	--	--

	- Hartimi i Kërkesës së datës 23.04.2026 në lidhje me propozimet dhe rekomandimet për Projektin Konceptual të QKMF-së drejtuar Menaxherit të projektit; - Koordinim i vazhdueshëm me përfaqësuesin e PRAK-ut në lidhje me Ftesën Publike, formimin e komisionit, përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve, Kryesinë e Këshillit, mandatin e tyre dhe çështje të tjera relevante, konform Marrëveshjes së Komunës së Kamenicës me Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve Sh.08 Nr.35566 të datës 12.11.2024; - Hartimi i Kërkesës Nr.19/2026 për MSh-në dhe KPSH-në për shuarjen e AMF-ve jofunksionale në Komunën e Kamenicës, si dhe procedimi i të njëjtës në Ministrinë e Shëndetësisë; -Takim me Administratën e DShMS-së, në funksion të shqyrtimit të Strategjisë së Kujdesit Parësor Shëndetësor 2022-2026 Sh.02 Nr.4819				
--	--	--	--	--	--

	e datës 13.02.2023, si dhe Planifikimi për riorganizimin e shërbimeve në QKMF; - Hartimi/plotësimi i Raportit të Monitorimit të Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik-Lokal në Komunën e Kamenicës, në lidhje me realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave të DShMS-së, në kuadër të SZhEL-së; - Hartimi i Kërkesës 22/2026 për furnizim me barna për pensionistë; - Hartimi i Kërkesës 23/2026 për furnizim me Baby Box (Produkte të domosdoshme për fëmijë të posalindur); - Pranimi dhe procedimi i Kërkesës për Specializim për vitin 2026; - Hartimi i Kërkesës për anagazhimin e specialistëve të profileve: Urolog, Gjinekolog, Pediatër dhe Radiolog;				
--	---	--	--	--	--

	- Organizimi i Dhurimit të Gjakut, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut; - Pjesëmarrjen në punëtorinë e parë për Hartimin e Planit të Mobilitetit të qëndrueshëm Urban (PMQU) në Komunën e Kamenicës; - Vizitë në QKMF-Kaçanik me karkater konsultativ në funksion të shkëmbimit të eksperiencave rreth menaxhimit sa më të mirë të institucioneve shëndetësore në nivel lokal në përgjithësi, si dhe ofrimit të shërbimeve efikase-shëndetësore në veçanti.				
Aktivitete të tjera	- Takim pune me Drejtorin e DShMS-së në Gjilan, në funksion të zgjerimit të bashkëpunimit ndër-komunal, në fushën e shëndetësisë primare; - Takim pune me përfaqësuesit e KFOR-it amerikan në lidhje me mundësitë e bashkëpunimit me DShMS-në;	Janar-Qershor 2026	/	1.Dr.Besart Kryeziu	Bashkëpunimi ndër-institucional

	- Takim pune me përfaqësuesit e Organizatës CHATAR CHAIRITY në lidhje me mundësitë e bashkëpunimit me DShMS-në; - Pjesëmarrje në trajnime të tjera, punëtori dhe tryeza diskutimi me qëllim të ngritjes profesionale; -Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët të avokimit për politika, në kuadër të projektit “Mbështetje psiko-sociale drejtuar nga bashkëmoshatarët për komunitetet e cenueshëm në Kamenicë; -Takim me OJQ DARDANA PRESS, me qëllim të diskutimit të misionit të kësaj organizate dhe mundësitë e bashkëpunimit me DShMS-në; -Takim me Krytarin dhe kryesinë e Kryqit të Kuq dega në Kamenicë, me qëllim të diskutimit dhe planifikimit të aktiviteteve të përbashkëta, në funksion të përmbushjes së objektivave të DShMS-së;				
--	--	--	--	--	--

	-Diskutim ne OJQ VORAE në funksion të informimit dhe mundësive eventuale të bashkëpunimit në kuadër të projektit “Puna ime e parë”; -Bashkëpunim i rregullt me Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik, në lidhje me situatën epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në vend dhe këtë e bënë përmes Sistemit digjital të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN); -Takim me Përfaqësuesit e Ndërmarrjes Publike “DARDANA”, në funksion të riorganizimit të strukturës së oborrit të QPS-së, si dhe largimit të rrethojave përgjatë objektit të këtij institucioni; -Takim me DShPAIE-në, me qëllim të shqyrtimit të mundësive për krijimin e hapësirave për praking të rezervuar për dy (2) veturat zyrtare të QPS-së; -Takim me fotografën e Komunës së Kamenicës z.Arian Mavriqi, me qëllim të pranimit të disa				
--	---	--	--	--	--

	fotografive si dhuratë për QKMF-Kamenicë dhe QMF-Roganë.				
--	--	--	--	--	--

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - KAMENICË (DShMS)

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Kamenicë “Dr.Shaban Geci”

(QKMF)

Raporti për periudhën Janar - Maj 2026

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Kamenicë me njësitë përbërëse të saj në periudhë Janar - Maj 2026 ka kryer veprimtarinë saj, që përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që kemi si institucion i nivelit parësor shëndetësor.

Ndër aktivitetet që vlen të theksohet janë:

- Më datën 20.01.2026 takim ne Gjilan ne ERSHP me Koordinatorët e Cilësisë, tema: Zbatimi i udhëzimit administrativ në lidhje me paraqitjen e sëmundjeve kronike joinfektive dhe infektive ne sistemin informativ SISH.
- Më datën 22.01.2026 vizitë në QMF Hogosht dhe QMF Roganë lidhur me respektimin dhe mbarëvajtjen e orarit të punës.
- Më datën 02.02.2026 ligjëratë në sallën e Kuvendit Komunal në Kamenicë, tema: Kanceri i qafës së mitrës, ligjërues Asllan Dërmaku.
- Më datën 03.02.2026 takim me specialistët Dr. Besart Kryeziu dhe Dr. Getoar Dërmaku lidhur me përfundimin e specializimit dhe fillimin e punës.

- Më datën 04.02.2026 në QKMF Kamenicë takim me përfaqësues të AQH-së, monitorimi dhe zbatimi i projekteve të AQH-së.
- Më 09.02.2026 takim i Këshillit Drejtues rreth organizimit të zgjedhjeve për Kuvendin e OMK-së.
- Më 18.02.2026 janë mbajtur zgjedhjet për anëtarë të OMK-së, në njësinë zgjedhore QKMF Kamenicë.
- Më 23.02.2026 takim i Këshillit Drejtues, ndryshimi i anëtarit të Këshillit Drejtues, në vend të Nafije Ajvazi, vie Ferdeze Kastrati.
- Më 13.03.2026 vizitë në QKMF Lipjan dhe Shtime, takim pune me drejtorët e dy QKMF-ve.
- Më 24.03.2026 trajnim në QKMF Kamenicë, parandalimi dhe menaxhimi në institucionet shëndetësore.
- Më 30.03.2026 mbledhja e Këshillit Drejtues, vijueshmëria përmes sistemit elektronik.
- Prill - Riorganizimi i orarit të punës (7:00-19:00 dhe 19:00-07:00), tani e tutje me kete riorganizim të orarit janë 2 mjek në ndërrimin e nates, që bënë të mundur që pacientëve të ofrohet një shërbim më i mirë jo vetëm në QKMF por edhe jashtë QKMF-se për vizita në rast thirrje për raste urgjente.
- Gjate kësaj kohe në muajin Prill kemi marrë si donacion një autoambulance
- Presim që së shpejti të fillojë edhe ndërtimi i QKMF-se së re, pasi siq kemi informuar procedurat janë në përfundim e sipër
- Prej muajit Prill kemi filluar me zbatimin e sistemit digjital të vijueshmërisë në punë të stafit në QKMF Kamenicë dhe QMF Rogane, së shpejti do të kryhet edhe në QMF Hogosht.
- Më 06.05.2026 takim në QKMF Kamenicë me Dr. Linda Çarkaxhiu nga AQH, vizitë montiruese nga mentori lokal.
- Më 12.05.2026 për nder të ditës së infermierisë është shënuar një aktivitet në qendër të Kamenicës nga ekipet mjekësore, ku kalimtarët e rastit kanë mundur të matin dhe sheqerin dhe tensionin.
- Më 14.05.2026 ligjëratë në QKMF Gjilan, tema: Shoku anafilaktik.
- Më 18.05.2026 në Gjilan të SP, është nënshkruar marrëveshja për asgjësim të mbetjeve medicinale.
- Më 18.05.2026 vizitë nga dy zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me mos raportimin e sëmundjeve ngjitëse në sistemin SMSN.

- Më 21.05.2026 ligjëratë në QKMF Gjilan, tema: Infeksionet e veshit të mesëm dhe të brendshëm.
- Më 08.06.2026 takim pune në Gjilan në kuadër të aktivitetit parapërgaditor për shënimin e ditës kundër drogës që do të jetë më 26.06.2026 në Gjilan me karakter shtetëror.



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
 GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
"Dr.Shaban Geci" KAMENICË

QKMF-KAMENICË Raport Statistikor I kontrollave ,shërb,shëndetsore për Pesëmujiin e parë-2026

Nr.	Lloji i shërbimeve	Mjekësia familjare	Urgjenca	Sherb. Pediat.	Punktet shëndetsore	Vizitat shtëpiak 0-3vjet	Sherb. Stomat.	Sherb.e Vaksin.	Mamografia	Gjinekologjia	Urologu	Sherb. R.T.G	Sherb. Labor.	Klasa për nëna	Totali
1	Kontrollim mjekësore	15641	7358	3269	13044		1332	973	792	379	1473				44261
2	Shërbimet medicinale	15641	24120	1867	13177	738	6374	5813	1082	628	1503	2767	63126	140	136976
3	Vizita shtëpiake		880		173										1053
4	Shërbimet shtëpiake		2647		790										3437
	Total	31282	35005	5136	27184	738	7706	6786	1874	1007	2976	2767	63126	140	185727

Të ref. jasht QKMF **2293**

Të trajtuar serb **650**

Të trajtuar rom **231**

Të huaj

Kordinatorja

Selvete Isufi

Ud.Kryeinfermierja

Ferdeze Kastrati

Drejtori i QKMF-së

Dr.Latif Sylaj

Institucioni Shendetesor:
Vendi-Kamenicë

121

RAPORT STATISTIKOR I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE të QKMF-së,QMF,AMF-së për Pesëmuajorin e parë-2026

	Llojet e shërbimeve	M.Familja	Urgjenc	Pediatria	Punktet Shënd.	Vaksi-onimi	V.Shtëpiake 0-3vjet	Mamografi	Gjinekologu	Urologu	Lab-Kamenic	Lab-Ro	Lab.Hod	RTG Kabine	S.Kam	RTG-Stom	S.Rog	S.Hog	Klasa për	Ekipa motor
1	Kontrollim mjeksore	15641	7358	3269	13044	973		792	379	1473					1067		265			
2	Shërbimet medicinale	15641	24120	1867	13177	5813	738	1082	628	1503	35532	25362	2232	2767	4784	289	897		140	
5	V.Shtëpiake		429		173															451
6	SH.Shtëpiake		870		790															1777
	Totali:	31282	32777	5136	27184	6786	738	1874	1007	2976	35532	25362	2232	2767	5851	289	1162	0	140	2228
	Llojet e shërbimeve	Roqana	Hogosht	Karaqeve	Koretin	Topanid	Sh.e lar	Desivoj	Muqiv	Strezov	Koperr	Krilevë	Tuxhe	Busav	Lisoc	Poli				
1	Kontrollim et	11719	1323																	
2	Shërbimet medicinale	10606	2367		197															
3	Vizitat shtëpiake	172	1																	
4	Shërbimet shtëpiake	789	1																	
	Totali:	23286	3692	0	197															
						9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nr.		Mjekësia familjare	Pediatria	Urgjenca	stomatologjia															
1	serb	441	23	138	58															
2	rom	110	22	73	26															
3	Të huaj																			
4	udhëzuar	1413	170	701	9															

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - KAMENICË (DSHMS)

**Qendra për Punë Sociale- Kamenicë
(QPS)**

Gjatë periudhës 01.01.2026-10.06.2026 në Sektorin e Shërbimeve Sociale janë pranuar gjithsej dyqindnjëzetedy (222) kërkesa të reja, nga individ dhe institucione, e të cilëve u janë ofruar shërbime profesionale nga ana e zyrtarëve të shërbimit social. Po ashtu përveç rasteve të reja të paraqitura, për shkak të natyrës së punës sociale, në shërbim kemi punuar edhe me raste të vjetra të bartura nga viti i kaluar, por edhe nga vitet tjera paraprake.

Më poshtë do të paraqesim në mënyrë tabelore të gjitha rastet e reja të paraqitura sipas kategorive:

Tabela nr.1.

Nr.ren	Kategoria e klientëve	Numri i rasteve të reja
1	Fëmijët pa kujdes prindëror	1
2	Të miturit në konflikt me ligjin	15
3	Fëmijët me sjellje asociale	6
4	Fëmijët me aftësi të kufizuara	6
5	Fëmijët e keqtrajtuar	5

6	Çrregullime të marrëdhënieve bashkëshortore	2
7	Rastet e dhunës në familje	21
8	Personat me aftësi të kufizuara/të rriturit	1
9	Kërkesa për lëshimin e vërtetime f.sh	64
10	Kërkesa për vërtetim për lënjen e shtetësisë	5
11	Kërkesa për vërtetime për zotësi veprimi	86
12	Konstatime/Pëlqime	5
13	Të tjerë	5
14	Gjithsej	222

Komente:

Përveç rasteve të reja , nga shërbimi janë trajtuar edhe rastet e bartura nga vitet paraprake nga të gjitha kategoritë ku në përgjithësi janë kryer këto shërbime:

- Fëmijët pa kujdes prindëror.

Nga kjo kategori në këtë periudhë, shërbime janë ofruar për shtatëmbëdhjetë (17) fëmijë të vënë nën kujdestari, prej tyre dymbëdhjetë (12) janë të strehuar tek të afërmit e tyre, dy (2) fëmijë janë të vendosur në strehim familjar jashtë farefisit, dhe tre (3) të tjerë nën kujdestari të përkohshme.

*Fëmijët e strehuar tek të afërmit, janë vizituar në familje dhe kemi pasur kontakte me kujdestarët ligjor.

*Fëmijët e vendosur në familje strehuese janë vizituar në familje, kemi mbajtur kontakte të kohëpaskohshme me familjet edhe përmes telefonit për ta përcjellë gjendjen e tyre.

Njërit rast në fillim të vitit i është zgjidhur statusi duke mbetur potencial për adoptim vendor. Për këtë rast është njoftuar Paneli për Adoptime në kuadër të DPSHSF, është aprovuar statusi nga Paneli dhe pasi na është propozuar një familje potenciale adoptuese nga Komuna e Vushtrrisë, në bashkëpunim me kolegët nga QPS Vushtrri, kemi realizuar vizitë në familje. Meqenëse nga shërbimi u konfirmua se familja është e përshtatshme për adoptim të fëmijës, është njoftuar sërish Paneli dhe pas marrjes së mendimit me shkrim, jemi dakorduar bashkërisht me QPS Vushtrri të fillohet me procedurat gjyqësore për adoptim.

Për rastin tjetër kemi parashtruar kërkesë komisionit komunal për ndarje të subvencionit nga lëmia e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

*Në përgjithësi rastet për të cilat u raportua si më lartë kanë qenë të bartura nga vitet paraprake, përveç njërit i cili ka qenë rast i ri, i fëmijës i cili përkohësisht është vënë nën kujdestari të gjyshes, deri në bashkimin familjar me prindin/babën i cili ndodhet jashtë vendit

.

- Te delikuenca e të miturve, gjatë kësaj periudhe kemi pranuar pesëmbëdhjetë (15) raste të reja të të miturve në konflikt me ligjin, prej tyre katër (4) të paraqitura nga prokuroria për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprave penale nga të miturit dhe njëmbëdhjetë (11) nga gjykata për shkak të kryerjes së kundërvajtjes.

Rastet e dyshuara për vepra penale janë vizituar në familje ku zyrtarët e shërbimit kanë kontaktuar me të miturit dhe prindërit e tyre me qëllim këshillimi dhe udhëzimi për përmirësim të sjelljeve. Veprat për të cilat dyshohen janë; sulmi dhe lëndimi i lehtë trupor.

Rastet që kanë kryer kundërvajtje po ashtu janë vizituar në familje ku janë këshilluar të miturit dhe familjet, dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme janë përgatit raportet hetuese sociale për gjykatë. Që të gjitha rastet kanë qenë kundërvajtje në komunikacion (pa patent shofer)

Nga këta të mitur dymbëdhjetë raste qenë të grup moshës 16-18 vjeç, ndërsa tri të grup moshës 14-16 vjeç, që të gjithë meshkuj të nacionalitetit shqiptar.

Për dy raste të bartur nga viti i kaluar, e të cilët kanë të shqiptuar masën edukative “Mbikëqyrje e shtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë, menaxheri i rastit ka realizuar vizita në familje, kontakte dhe sesione këshilluese me të miturit në QPS, si dhe ka përgatitur raportet periodike për gjykatën kompetente.

Gjithashtu kemi pasur edhe raste të asistimit në polici me rastin e intervistimit të të miturve, qoftë si të dyshuar, si viktimë apo dëshmitarë.

- Nga kategoria e fëmijëve me sjellje asociale, kemi pasur gjashtë (6) raste të reja, ku që të gjithë janë vizituar në familje, kemi këshilluar të miturit dhe familjet e tyre dhe kemi bashkëpunuar me shkollat ku ata vijnë në mësimet.

Nga këto raste, tre kanë qenë të mitur të përfshirë në një incident në autobusin e transportimit të nxënësve, ku janë intervistuar si të dyshuar ose dëshmitar të rastit, një rast ka qenë i mitur i cili ka ngacmuar/bullizuar bashkëmoshataren e tij, rasti tjetër është një fëmijë i

cili nuk qëndron në shkollë pa prezencën e nënës, duke shkaktuar probleme në procesin edukativo-arsimor dhe i fundit një i mituri i përfshirë në rrahje me bashkëmoshatarë.

Varësisht nga natyra e sjelljes asociale të shfaqur kemi bashkëpunuar edhe me policinë, ku janë dërguar procesverbalet e deklaratave të të miturve dhe raporte me shkrim.

- Te kategoria e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kemi pranuar gjashtë(6)kërkesa të reja nga prindër që kujdesen për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

Në këtë periudhë raportuese, është mbajtur një seancë vlerësimi e Komisionit Mjekësor shkalla e parë, në QPS Gjilan, ku e kemi prezantuar tri raste (një nga viti i kaluar). Nga rastet e shqyrtuara, një ka munguar, një ka mbet me plotësim dokumentacioni dhe një rast është shqyrtuar pozitivisht, duke u përfshirë në pagesë të rregullt mujore.

Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur kontakte me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, raste aktive të bartura nga e kaluara, ku disa prej tyre janë vizituar në familje me qëllim përcjellje të gjendjes e disa janë paraqitur në zyre.

Dy raste janë ndërprerë nga skema, për shkak të arritjes së moshës madhore.

Në këtë periudhë të vitit në pagesë kemi gjithsejtë pesëdhjetepesë (55) raste.

- Nga kategoria e fëmijëve të keqtrajtuar kemi punuar në pesë (5) raste, prej tyre tre raste të raportuar për dhunë brenda familjes.

Në njërin nga këto raste e mitura(16 vjeçe) është përzënë nga shtëpia pasi është zbuluar se është në lidhje dashurie me një bashkëmoshatar të saj. Pas intervistimit në polici, e mitura është dërguar në strehimore ku ka qëndruar gjatë vikendit, ndërsa me të filluar java pas dy netësh babai e ka pranuar në shtëpi.

Rasti tjetër ka qenë një rast i përsëritur nga viti i kaluar ku dy të mitura/motra janë larguar nga shtëpia si pasojë e dhunës psikologjike të babait. Në këtë rast shërbimi ka parashtruar kërkesë për urdhër mbrojtje në gjykatë, ku edhe është aprovuar me urgjencë kërkesa jonë duke ju hequr e drejta prindërore babait përkohësisht dhe vendosja nën kujdesin e nënës.

Rasti i katërt, ka qenë e mitur e bullizuar nga bashkëmoshatar i saj në shkollë, ku është vizituar e mitura në familje dhe në shkollë, është intervistuar dhe këshilluar dhe janë ofruar shërbime këshilluese edhe për të miturin ngacmues dhe familjen e tij.

Dhe rasti i pestë ka qenë i një të miturit i plagosur me armë zjarri nga persona të njohur jashtë familjes. Ky i mituri është intervistuar nga ana e shërbimit në banesën e familjes së tij në Prishtinë.

- Në kategorinë e çrregullimeve bashkëshortore, kemi pranuar dy (2)raste të reja, kërkesë nga gjykata për ndërmarrje të verimeve të tentim pajtimit dhe dhënie të mendimit për besim të fëmijëve.

Rastet janë trajtuar nga shërbimi përmes vizitave në familje, intervistave dhe këshillimeve bashkëshortore, intervistave me fëmijët mbi dhjetë vjet dhe janë përgatit mendimet për besim të fëmijëve dërguar gjykatës kompetente.

Po ashtu kemi punuar edhe në raste tjera të bartura nga viti i kaluar, ku kryesisht kemi prezantuar nëpër seanca gjyqësore, për prezantim të mendimit të dhënë paraprakisht me shkrim.

- Kemi punuar në njëzetën (21) raste të dhunës në familje, kryesisht janë raportuar nga policia, përmes raportit ditor të dhunës familjare. Që të gjitha rastet janë vizituar dhe këshilluar nga ana e shërbimit, janë vlerësuar nevojat e tyre dhe janë përgatit raporte me shkrim për policinë dhe prokurorinë.

Në disa raste kemi marrë pjesë në seanca gjyqësore, ku kemi dhënë mendimin profesional, në procedurë sipas kërkesës për urdhër mbrojtje.

Prej të gjitha rasteve dhjetë viktima janë femra (të dyshuar në shumicën e rasteve janë bashkëshortët, një rast djali,) dhe njëmbëdhjetë meshkuj(të dyshuar vëllezërit ose në raporte tjera familjare). Për nga nacionaliteti pesëmbëdhjetë janë shqiptar, pesë serb ,vetëm një i nacionalitetit rom.

- Në kategorinë e kontakteve fëmijë prind kemi punuar në shtatë (7) raste, që të gjitha raste të vjetra.

Katër raste i mbajnë kontaktet në ambiente të QPS, të përcjellura me vështirësi të kohëpaskohshme, por kryesisht të tej kalueshme përmes intervenimit të zyrtarëve të shërbimit, të ngarkuar me menaxhim të rasteve.

Tri raste kontaktet i mbajnë jashtë QPS , gjatë vikendeve por pranimi dhe dorëzimi i fëmijëve bëhet përmes QPS.

Përveç këtyre rasteve, shërbime janë dhënë kohë pas kohe edhe për raste të tjera që mbajnë kontaktet jashtë QPS, por që kanë pasur nevojë për ndihmën tonë kryesisht me qëllim ndërmjetësimi për realizimin e kontakteve.

- Në kategorinë personave me retardime mendore kemi vizituar klientët tanë që ndodhen të strehuar në Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Kamenicë ku jemi njoftuar me gjendjen e tyre të përgjithshme. Për dy klient të strehuar në këtë institucion kemi parashtruar kërkesë/propozim për vazhdim të strehimit rezidencial, Panelit për Strehim Rezidencial në nivel lokal, ku pas marrjes së Pëlqimit për vazhdim qëndrimi, kemi nxjerr vendimet dhe marrëveshjet për strehim me institucionin rezidencial.

Nga kjo kategori kemi pasur edhe kontakte me kujdestarë të personave me aftësi të kufizuar mendore të cilëve ju është hequr aftësia e veprimit , e të cilët kanë raportuar për kryerjen e detyrave të kujdestarisë për vitin paraparak.

Një rast i ri është paraqitur nga gjykata sipas propozimit të familjes për heqje të zotësisë së veprimit. Në këtë rast është vizituar pala, kemi përfaqësuar të njejtën në procedurë gjyqësore si kujdestarë i përkohshëm dhe tani pas marrjes së vendimit nga gjykata përmes të cilit i hiqet plotësisht zotësia e veprimit, pritet ti caktohet kujdestari i përhershëm ligjor.

- Në kategorinë e personave me sëmundje mendore, kemi punuar në disa raste , kryesisht të vjetra të bartura nga periudha paraprake, e të cilëve u janë ofruar shërbime varësisht nga nevoja.
- Kemi pranuar pesë (5) kërkesa për Konstatime respektivisht Pëlqime, tri prej tyre me qëllim bashkimi familjar kryesisht të personave të moshuar(të vetmuar) me familjarët jashtë vendit, një me qëllim ndërrimi të shkollës për fëmijën dhe një rast me qëllim marrje të pëlqimit për udhëtim të fëmijëve jashtë vendit.
- Një(1) kërkesë ka qenë për dhënie të lejes për kryerje të punëve juridike nga kujdestari i personit që i është hequr zotësia e veprimit.
- Një (1) kërkesë ka qenë për dhënie të Lejes për tjetërsim të pronës së fëmijëve, parashtruar nga një nënë vetushqyese.
- Shërbimi ka kryer edhe punë administrative; dhënie të vërtetimeve me kërkesë të klientëve, ku gjithsej janë lëshuar njëqindpesëdhjetepesë (155) vërtetime, gjashtëdhjetekatër (64) për fitim shtetësie, pesë (5) për lirim nga shtetësia, dhe tetëdhjetegjashtë (86) për posedim të zotësisë së veprimit.

- Shërbimi ka menaxhuar bazat e të dhënave ku janë regjistruar me kohë rastet dhe janë dërguar me kohë të dhënat në DSHSMF/MD, për administrim të pagesave dhe përcjellje të dukurive të shprehura në komunën tonë.
- Po ashtu janë regjistruar të gjitha rastet dhe intervenimet edhe në data bazën e dhunës në familje.
- Kemi mbajtur lidhje të rregullta me DSHSMF/MD-në duke dërguar, regjistrat e pagesave për fëmijët që ndodhen në strehim tek të afërmit dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe regjistrat për Panel për fëmijët potencial për strehim e adoptim dhe familjet potenciale strehuese e adoptuese në komunën tonë.
- Pjesëmarrje në grupe punuese e komisione komunale si: Komisioni për ndarje të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komisioni për ndarje të subvencioneve për të porsalindurit, Komisioni për monitorim të projekteve të bizneseve dhe OJQ-ve, që kanë përfituar grante dhe subvencione nga komuna, Komisioni për matje të performances komunale, Komisioni për arkivim të lëndëve, Ekipi Komunal për Vlerësim Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, Komisionet për çështje të banimit , Komisioni për ndihmë pronarëve për themelimin e shoqatës së pronarëve. etj.
- Pjesëmarrje aktive në takimet e Panelit për Adoptime dhe Panelit për Strehim Rezidencial në nivel lokal.
- Pjesëmarrje në takime, trajnime e punëtori, të organizuara nga niveli qendror dhe ai lokal
- Kemi mbajtur kujdestarinë pasive njëzetekatër orëshe ku i jemi përgjigjur thirrjeve të policisë pas orarit të rregullt të punës.
- Kemi bashkëpunuar me institucionet tjera si me policinë, gjykatat, prokurorinë, QPS-të homologe , QKMF-në, shkollat, QSHM-në, OJQ dhe institucionet tjera komunale.

I PUNËS TË SHËRBIMIT SEKTORIT TË NDIHMAVE SOCIALE NË QENDREN PËR PUNË SOCIALE NË KAMENICË PËR PERIUDHËN JANAR 2026 – MAJ 2026

Në Shërbimin e Sektorit të Ndihmave Sociale në QPS-së Kamenicë, punojnë 2 zyrtar të Asistencës Sociale dhe Udhëheqsi i SHSNS . Në këtë shërbim punët dhe shërbimet për shfrytëzuesite ndihmës sociale kryhen konform Ligjit mbi Skemën e ndihmës sociale 2003/15, Rregulloren implementuese të këtij ligji, Ligjin nr.04/L-096 për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për SNS , Udhëzimeve dhe Urdhërësive Administrative të nxjerra nga MPMS respektivisht DPSF-ja .Gjithashtu dhe Pilot Projekti i SAS-it të ri Ligji për ndihma sociale për vitin 2024 sipas udhëzimeve të MFPT Për të parë dhe analizuar punën e SHSNS dhe për të dhënë komente duhet ti paraqesim në mënyrë tabelare shënimet:

■ Numri i kërkesave të reja dhe të ripërserirura.

Muajt e Janar – Prill 2026	Kërkesat e reja		Ripërseritje- Riaktivizim		Të pranuara		K.Mjekësor		Komente Shtesë
	Kategoria		Kategoria		Kategoria				
	I	II	I	II	I	II			
Janar	2	1	1	0	3	1	21 KM		11 aprovim.10 refuzim
Shkurt	2	1	0	1	3	1	20 KM		20 aprovim

Mars	2	1	1	4	3	6	18 KM		17 Aprovim,1 refuzim
Prill	1	0	1	0	2	0	15 KM		15 Aprovim
Maj	0	0	1		1	0	29 KM		24 Aprovim,4 refuzim
Qershor									
Korrik									
Gusht									
Shtator									
Tetor									
Nëntor									
Dhjetor									
Gjithsej	7	3	14	5	12	8	103 KM		

Muajt e vitit 2025	Nr.familjeve	Antarët e familjes	Pagesa Mujore	Komente shitesë
Janar	270	956	37.932 Euro	
Shkurt	272	947	38.424 Euro	
Mars	274	959	38.184 Euro	
Prill	267	936	37.248 Euro	
Maj	266	929	37.260 Euro	
Qershor				
Korrik				
Gusht				
Shtator				
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				

■ Nderprerja e ndihmave Sociale si dhe lëndet që kanë qenë në komision mjekësor për këtë periudhë.

Muajt e Vitit 2025	Nderprerja e ndihmës sociale		Lëndët në Komision mjekësor në Gjilan				Komente shtesë
	K a t e g o r i a		Kategoria I				
				poz	neg	Rishqyr	
Janar		6	21	11	10	0	
Shkurt		2	20	20		0	
Mars		4	18	17	1	0	
Prill		5	15	15	0	0	
Maj		4	29	24	5	0	
Qershor							
Korrik							
Gusht							

Shtator							
Tetor							
Nëntor							
Dhjetor							
Gjithësejt		21	103	87	16	0	

■ Ushtrimi i ankesave në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë Komisioni i ankesave pranë DNS-së.

Muajt e Vitit 2025	Ankesat në shka-I-rë USNS-së		Sa janë aprovuar		Sa janë refuzuar		Ankesat në DPSF shkall e II-të	
	kategoria		kategoria		kategoria		kategoria	
	I	II	I	II	I	II	I	II
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0

Mars	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor								
Korrik								
Gusht								
Shtator								
Tetor								
Nëntor								
Dhjetor								
Gjithsej								

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur Ankesa të paraqitura në shkallën e dytë.

▣ Riaplikimi i kryer me dokumente të nevojshme.

Muajt e vitit 2025	Riaplikimi i kryer me kohë		Komente shtesë
	K a t e g o r i a		
Janar	43 familje	22 kat 1 dhe 21 kat 2	
Shkurt	35 familje	22 kat 1 dhe 13 kat 2	
Mars	27 familje	22 kat 1 dhe 5 kat 2	
Prill	35 familje	28 kat 1 dhe 7 kat 2	
Maj	35 familje	17 kat 1 dhe 18 kat 2	
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			

Nëntor		
Dhjetor		
Gjithësejt:	175 familje	

■ Vërtetimet që familja është në social dhe nuk është social.

Muajt e vitit	Merr social	Nuk merr social	Gjithësejt:
Janar	2	0	2
Shkurt	1	0	1
Mars	1	1	2
Prill	2	0	2
Maj	2	3	5
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			

Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
Gjithësejt:	8	4	12

■ Rastet e kthimit të mjeteve nga ATK-ja.

Muajt e vitit	Nr rasteve	Gjithësejt:
Janar	3	3
Shkurt	0	0
Mars	3	3
Prill	1	1
Maj	1	1
Qershor		
Korrik		
Gusht		

Shtator		
Tetor		
Nëntor		
Dhjetor		
Gjithsej:	8	8

Spektori i Asistencës Sociale në Komunën e Kamenicës ka për qëllim ofrimin e mbështetjes sociale për familjet dhe individët në nevojë, mbështetur në legjislacionin në fuqi që e rregullon Skemën Sociale në Kosovë.

Ky raport paraqet aktivitetet dhe të arriturat për periudhën mujore Janar - Maj 2026.

Komuna e Kamenicës ka 22.868 banorë sipas regjistrimit të fundit të popullësisë prej tyre një pjesë e familjeve janë përfitues të Skemës Sociale.

Shuma e ndihmës sociale varion nga 84€ deri në 252 €, në varësi prej numrit të anëtarëve të familjes.

Aktivitet kryesorë të sektorit për periudhën raportuese janë:

- Identifikimi dhe evidentimi i familjeve në nevojë;
- Verifikimi i kushteve sociale të familjeve;
- Përditësimi i bazës së të dhënave;

Menaxhimi me Skemën Sociale në Kamenicë

- Pranimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve;
- Vendimmarrja për përfituesit dhe refuzuesit e aplikacioneve;
- Monitorim i rasteve aktive sociale;

Shërbimet rreth asistencës sociale

- Këshillim social për familjet sociale;
- Referimi i palëve në institucione relevante;

Bashkëpunimi institucional

- Bashkëpunim me Departamentin e Ndihmave Sociale;
- Bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale Komuna të tjera për praktika sociale;
- Koordinim me Rajonin e Gjilanit lidhur me lëndet e Komisionit mjekësor;
- Bashkëpunim me Zyrën Komunale të Punësimit Kamenicë;
- Bashkëpunim me Degën e Kryqit Kuq në Kamenicë;

Përfituesit e skemës sociale janë familjet;

- Familjet pa të ardhura financiare;
- Familjet / Prindërit vetëushqyes;
- Familjet / Personat e vetëm;
- Familjet që kanë anëtarë me probleme shëndetësore;

Punë dhe angazhime tjera;

- Takime të rregullta me drejtorin e DSHMS-së dhe QPS-së për punët mujore;
- Takime dhe mbikqyrje e punëve me zyrtarët e SAS për muajin periudhën Janar – Maj 2026;
- Koordinim dhe organizim e mbikqyrje të punëve në sektorin e SAS;
- Bashkëpunim me kolegët e DSHMS-së dhe Sektorit të Shërbimeve Sociale lidhur me rastet e ndërlidhura dhe raste tjera;
- Përgaditja e planit të punës dhe vizitave në terren dhe periudhën Janar – Maj 2026; ,
- Përgaditja e listave për riaplikim, lista e pagesave, raportet nga baza e

shënimeve për periudhën Janar – Maj 2026; ,

- Punët në teren nga Udhëheqësi dhe dy zyrtarët e SAS, verifikim të kërkesave të reja dhe riverifikim për raste tjera në gjitha lokalitetet e Komunës Kamenicës, qytet dhe fshatra;
- Hartimi i Listës për Komision mjekësor, kontrollimi i aplikacioneve dhe kompletimi i tyre me formular.

- Punët në bazën e shënimeve sipas Ligjit të SNS, regjistrimi i të gjitha riaplikimeve në bazë , regjistrimi i kërkesave të reja në bazë , ndërprerjet e ndihmave sociale si dhe aprovimi i tyre.
- Hartimi i vendimeve pozitive dhe negative për të gjitha aplikacionet ,
- Punët në teren nga NNS verifikim të kërkesave të reja SAS-i i ri;
- Ligji i Ri SAS – Pilot 75 familje përfituese, 194 anëtarë, 98 femra dhe 94 meshkuj;
- Këshillim i rasteve sociale për mundësi punësimi dhe këshilla tjera;
- Mbështetje për aplikim për subvencionimin e energjisë elektrike për familjet e cënueshme sipas Vendimit të Qeverisë 60-4/2025;
- Takim pune me zyrtarët e Zyrës Punësimi për bashkëpunim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Takim pune me përfaqësuesin e Kryqit të Kuq në Kamenicë për mbështetje dhe bashkëpunim për identifikimin e rasteve më të rënda sociale;
- Angazhime në punë dhe takime me Komisionin Komunal për Inicimin dhe Ndihmën ndaj Pronarëve të Ndërtesave në Bashkëpronësi për krijimin e shoqatave të pronarëve Sh 02 Nr 2367 datë: 27.01.2026 ;
- Angazhime në punë dhe takime në Komisionin Vlerësues për verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes/individit të vendosur në njësi të banimit në kuadër të Ndërtesës së Banimi Social sipas Vendimit Sh 02 Nr 4434 datë: 18.02.2026;
- Angazhime në punë dhe takime në Komisionin Komunal për Kthim sipas Vendimit Sh 02 Nr 6917 datë: 17.03.2026.

Shtëpia e Komunitetit – Kamenicë

(ShKK)

HYRJE

Me Marëveshjen e Mirëkuptimit të lidhur në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Nr.220 të datës 14.08.2015, Shtëpia e Komunitetit Për Persona me Aftësi të Kufizuar Mendore në Kamenicë-Sherbime Sociale Rezidenciale ka kaluar në menaxhimin e Komunës nga data 01.01.2016 respektivisht nën Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kapaciteti i këtij institucioni është 10 (Dhjetë) persona, kurse të vendosur kemi 11 (Njëmbdhjetë) persona, të cilët janë në qëndrim dhe përkujdesje 24 orëshe në institucion.

Institucion është regjional ku kemi të vendosur rezidentë nga Komuna të ndryshme :Kamenicës Gjilan ,Viti , Prishtinë dhe Novobërd. Struktura nacionale e rezidentëve është e perzier ku kemi 7 rezidentë shqiptarë, 2 sërëb,dhe 2 rom,kurse struktura gjinore është 9 femra dhe 2 meshkuj.

Stafi i rregullt i këtij institucioni është 10 zyrtarë ; përbëhet nga udhëheqsi, 5-Infermier/e , 3-Ndihmës Infermier, 1 Mirëmbajtës dhe 1-Kuzhinierë. (tani kemi të angazhuar edhe 1 ndihmëse Infermiere me kontratë “Shërbime të Veqanta”.

Gjendja shëndetsore (psiqike - emocionale) e rezidentëve është e ndryshme, ne kemi katë rezidentë në gjendje më të rëndë të cilët nuk janë të vetëdijshëm as për nevojat e tyre fiziologjike, andaj gjatë 24 orëve jemi të detyruar ti mbajmë me pampersa dhe me një përkujdesje të shtuar ndaj tyre. Pjesa tjetër e rezidentëve kanë një gjendje më të mire,por nuk janë në gjendje të kujdesen për pastërtinë personale asnjëri nga rezidentët e tjerë.

Të gjithë rezidentët janë e vendosur në institucionin tone kanë letërnjoftimet e Republikës së Kosovës, kanë të marur me vendimet e gjykatës "Zotësinë e veprimit" qka do të thotë se këta persona nuk kanë asnjë përgjegjësi ligjore për veprimet e veta. Po ashtu të gjithë rezidentët e vendosur në institucionin tone kanë të caktuar kujdestarët e përhershëm ligjor të caktuar nga Qendra për Punë Sociale (Organi I Kujdestarisë) prej nga vijnë rezidentët.

Këto janë kritere për vendosjen e rezidentëve sipas udhëzimit administrative. Rezidentët vendosur në institucione të këtilla para vitit 1999 kanë qëndrim të përhershëm (5 persona), kurse pjesa tjetër kanë qëndrim të përkohshëm një vjeçarë dhe vazhdimi i qëndrimit të tyre bëhet në bashkpunim dhe sipas kërkesave të QPS-ve gjegjëse (6 persona).

Përkatësia e tyre etnike është si vijon:

VITI	Shqiptar		Sërb		Mysliman		Kroat		Rom		Hungarez		Turk		Gjithsej
2026	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Janar-mars	1	6		2					1	1					11
Prill - Qershor	1	6		2					1	1					11

SHTYLLA E PUNËS NË INSTITUCIONIN "SHTËPIA E KOMUNITETIT"

Institucioni "Shtëpia e Komunitetit "ka tri shtylla kryesore të veprimtarisë:

- 1.Mbrojtja dhe përkujdesja sociale ndaj rezidentëve të vendosur në institucion.
- 2.Mbrojtja dhe përkujdesja shëndetsore ndaj rezidentëve të vendosur në institucion.
- 3.Socializimi , integrimi dhe ngritja e aftësive të tyre.

1.Mbrojtja dhe përkujdesja sociale-nënkupton përkujdesjen ndaj rezidentëve 24/24,duke filluar nga akomodimi,ushqimi,veshëmbathja,pastrimi dhe qdo nevojë e tyre personale apo kolektive.

2.Mbrojtja dhe përkujdesja shëndetsore nënkupton : Trajtimet mjekësore sipas nevojave të rezidentëve,kontrollimet e rregullta në ambulancat specialistike,dy here mbrenda vitit të obligueshme(Neuropsikiatri,Gjinekologji,Interno,Pulmologji,Neurologji,Infektivë, Stomatologji).Analizat e përgjithshme laboratorike dy herë mbrenda vitit,vaksinimi kundër gripit dhe të gjitha trajnimet e tjera të cilat mund të paraqiten te secili rezidentë veq e veq.

3.Socializimi dhe ngritja e aftësive të tyre-nënkupton: Socializimin me komunitet dhe rethinë ku jetojnë,duke organizuar shetitje, ekskurzione, pikënikë një ditorë, lojra të ndryshme, gara,gjimnastikë, vizita në teatro, shiqim i ndonjë ndeshje sportive etj.Me këta rezidentë punohet në ngritjen e aftësive të humbura,duke u menduar të rrisim aftësitë për vetëkujdesje sa më shumë që është e mundur.

MONITORIMI DHE INSPEKTIMI I PUNËVE NË INSTITUCIONIN TONË

Ne i kemi të caktuara standardet minimale të ofrimit të shërbimeve shëndetsore për rezidentët të përcaktuar nga ministria gjegjëse dhe nga Bashkimi Evropian , ku përfshihen të drejtat, liritë, organizimi i punës, përkujdesja dhe trajtimi i tyre i përgjithshëm.

Menaxhimi, kontrollimi dhe inspektimi mbi ofrimin e shërbimeve ndaj kësaj kategorie të personave bëhet nga shumë organizata dhe institucione të ndryshme:

- Mbikqyrja e drejtëpërdrejtë bëhet nga komuna, gjegjësisht nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
- Kontrollimet e kohëpaskohëshme bëhen nga:
- Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe Drejtave të Njeriut (KMLDNJ),
- Avokati i Popullit(keto të gjitha kanë leje nga ministria gjegjëse,
- Inspektimi bëhet nga komisioni I ministrisë gjegjëse respektivisht nga Departamenti I Politikave Sociale dhe të Familjes (Ministria e Drejtësisë).

Punët Rutinore – të përditëshme në institucion:

- Përkujdesja e vazhdushme 24/24 orë në ditë për shëndetin, ushqimin , pastrimin, veshjen ,terapinë e 12 rezidentëve në institucion.
- Ushqimi rezidentëve i është servuar tri herë në ditë, si dhe dy herë në mes të shujtave janë shërbye me kafe, embelsira , dhe pemë të ndryshme.
- Terapia e rregullt i është dhënë tri herë mbrenda 24 orëve e në raste të veqanta sipas rekomandimit të ekspertëve shëndetësor.

- Pastrimi personal i rezidentëve është bërë një here mbrenda ditës për rezidentët e pavarur, kurse për rezidentët gjysëm të varur bëhet sipas nevojave nga tri-katër herë mbrenda 24 orëve.
- Pastrimi i ambienteve të institucionit bëhet dy herë mbrenda ditës, kurse në tualetet dhe koridorin bëhet disa herë sipas nevojës dhe urgjencave. Pastrimi gjeneral i institucionit është bërë për qdo javë.
- Matja e tensionit arterial, matja e pulsit ofrohet 5 ditë javë rregullisht, kurse në raste të caktuara ofrohet matja e glikemisë dhe temperaturës sipas nevojës.
- Matja e peshës trupore për të gjithë rezidentët.
- Pastrimi i rrobave të ditës për rezidentët dhe veshjet e natës pastrohën për qdo ditë.

Puna okupuese dhe relaksuese zhvillohet qdo ditë me rezidentët : si në paisje fitnesi, shiqim i televizionit, shëtitje mbrenda parkut të institucionit, lodra të ndryshme, dialogje të ndryshme etj.

TRAJTIME MJEKËSORE DHE GJENDJA EMOCIONALE-PSIKOLOGJIKE E REZIDENTËVE

Në kemi kemi të caktuara standardet minimale të ofrimit të shërbimeve shëndetsore për rezidentët,ku përfshihen kontollime të rregullta dy here mbrenda vitit të specialistët nga lemitë përkatëse.Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore rezidentët i kemi pasur në kontrolla specialistike të ndryshme sipas planit të punës, ku deri më datën e raportimit kemi realizuar mbi 80% të planit individual për rezidentët.

Të gjithë rezidentët janë në terapi të rregulltë ditore, sipas rekomandimeve të mjekëve specialist të fushave të ndryshme, kurse terapia dhe intervenimet e vogla bëhen nga stafi i mesëm (infermierët) në institucion.

Gjatë kësaj periudhe, gjendja shëndetsore, emocionale dhe psikologjike të shumica e rezidentëve ka qenë relativisht e qëndrueshme dhe stabile me disa intervenime të kohëpaskohshme shëndetsore në raste të caktuara. Por kemi patur keqësimin e gjendjes shëndetësore të katër

rezidentëve me të cilët jemi marrë rregullisht me trajtimet e shumëta dhe të ndryshme mjekësore. Por nuk kanë munguar edhe shqetësimet e herëpasëherëshme të disa rezidentëve tjerë, e në disa raste sjellje agresive dhe vetëlendime dhe lëndime të rezidentëve tjerë.

Përpos tyre kemi pasur edhe ndonjë ftohje të rezidentëve , gripe të ndryshme dhe ngritje të tensionit arterial në disa raste. Rezidentëve tjerë i janë bërë edhe analiza tjera të shumëta sipas nevojave dhe rekomandimit të stafit mjekësorë.

Gjatë kësaj periudhe kemi punuar shumë në shëndetin dhe gjendjen e përgjithshme shëndetsore të rezidentëve, duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore:

-Të gjithë rezidentëve i janë bërë analizat e rregullta laboratorike, kurse disa rezidentëve analizat I janë përsëritur disa herë sipas rekomandimeve të mjekëve. Gjatë kësaj periudhe përkujdesja shëndetsore ndaj rezidentëve ka qenë e shtuar dhe efikase, duke ju ofruar të gjitha trajtimet e nevojshme dhe të rekomanduara nga institucionet shëndetsore. Terapitë e caktuara nga mjekët kompetent janë ofruar me rregull dhe në kohën e caktuar, por, edhe Tensioni Arterial, Puls, Glukoza janë matur me kohë duke respektuar planin e punës. Në formën statistikore këto shërbime duken kështu:

Lloji i Shërbimit	Pulsi	Glukoza	Oksigjeni	Tensioni Arterial
Matjet e rregullta gjatë kësaj periudhe	27	7	27	194
Matjet ad – hoc sipas nevojave të rezidentit				

Higjena personale e rezidentëve është mbajtur në nivelin e dëshiruar, por edhe veshmbathja, hixhena e objektit dhe lavantaria kan qenë të kënaqshme. Gjithashtu rëndësi e theksuar iu është kushtuar edhe ambientit jashtë objektit, duke mbajtur parkun, lodrat dhe të gjitha pasijet tjera në rregull.

Raportet e përgjithshme në institucion kan qenë tolerante dhe bashkëpunuse, duke krijuar një ambient të qetë dhe relaksus për rezidentët. Gjithashtu kujdes të shtuar kemi patur në punën okupuse dhe relaksuse me rezidentët, duke organizuar lojra të ndryshme, debate, shëtitje, paisje fitnesi, shiqim I TV, etj. Gjatë kësaj periudhe kemi organizuar tri ditë pik-nik në natyrë me rezidentët.

Nese i paraqesim të gjitha vizitat dhe kontrollimet mjekësore në formë tabelare duken kështu:

TABELA E KONTROLLIMEVE TË NDRYSHME SHËNDETSORE PËR REZIDENTËT E VENDOSUR NË SHITËPINË E KOMUNITETIT NË KAMENICË PËR PERIUDHËN JANAR- Qershor / 2026

Trajtimet specialistike në Spitalin Rajonal të Gjilanit	Institucio n privat- shendetes or	Trajtimet specialistike te gjinekologu	Kontrolli met në QKMF në Kamenicë	Infuzione ,injeksion e, lidhje pastrim në QKMF në Kamenicë	Analiza të ndryshm e në QKMF në	Analiza t laborat or privat	Kontro llime psikiat rike	Trajtime ne QKUK Prishtinë
---	--	---	--	---	--	---	------------------------------------	-------------------------------------

					Kameni cë				
43	4	8	35	16	23	4	11	0	

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë periudhës Janar-Qershor /2026 kemi pasur shumë trajtime dhe kontrollime, analiza te ndryshme mjeksore.

Gjatë kësaj periudhe kemi punuar në përmbushjen e planit individual të secilit rezident në aspektin shëndetësorë, emocional dhe social. Në secilin muaj kemi caktuar nga një infermier/e përgjegjës/e e/ cila ka punuar i/ e cila/i është marrë me aktivitetet e nevojshme në përmbushjen e planeve individuale për rezidentët.

Në planet individuale janë përfshi të gjitha trajtimet e nevojshme shëndetësore , ku kemi parapa për të gjithë rezidentët analizat e përgjithëshme laboratorike, kontrollimet specialistike te Internisti, Pulmologu, Infektologu, në dy raste te neurologu dhe në tetë raste të Gjinekologu. Këto trajtime të parapara me planin individual kan përfunduar te secili rezident në afatin optimal. Gjatë kësaj periudhe kontrollime psikiatrike I janë kryer 1 herë të gjithë rezidentëve.

Gjatë këtyre kontrolleve janë zbuluar probleme tjera shëndetësore te tre rezident , të cilët janë në trajtime të vazhdueshme

Gjatë kësaj periudhe të vitit kemi patur raste të rënda të trajtimeve shëndetsore, me të cilat jemi marrë intenzivisht duke I trajtuar nëpër institucione përkatëse sipas rekomandimeve të mjekëve. .

Plani invidual për rezidentët është realizuar diku 80% dhe ka mbetur edhe disa kontrollime dhe trajtime me termine te caktuara. Nëse i referohemi tabelës së lartëcekur shohim se kemi realizuar 43 kontrollime specialistike në Spitalin Rajonal të Gjilanit(internisti, pulmologu, neurologu, kardiologu, infektologu, gjinekologu)etj.

Po ashtu kontrollime të ndryshme për rezidentet kemi kryer edhe në QKMF Kamenicë- gjithësejt 35 kontrollime te mjeku familjarë,në 23 raste rezidentëve I janë bërë analiza të ndryshme, infuzione, injeksione . –gjithësejt 16..

Në mungesë të angazhimit të psikiatrit në institucion kemi bashkpunuar me Qendren e Shëndetit Mendor dhe Spitalin Regjional të Gjilanit për realizimin e kontrolleve psikiatrike për rezidentët.

Gjatë kësaj periudhe kemi patur një gjendje shëndetsore të paqëndrueshme te shumica e rezidentëve duke realizuar edhe trajtime të shumët nëpër institucionet shëndetësore.

Me QKMF në Kamenicë kemi një bashkpunim shumë të afërt, profesional dhe afatgjatë, të cilët po na dalin ne ndihmë në shumë shërbime profesionale të cilat janë të nevojshme për institucionin tonë. Nga kjo qendër ne kemi siguruar analizat e përgjithshme laboratorike për të gjithë rezidentët, gjatë kësaj periudhe kemi kryer kontrollat dhe analiza të ndryshme mjeksore sipas nevojave të rezidentëve.

Me Spitalin Rajonal të Gjilanit punët nuk po na ecin si duhet, këtu po hasim në rezistencë të mjekëve specislist, mospërfillje , neglizhencë dhe oportunitizëm. Në të shumtën e rasteve kontrollet mjekësore bëhen sa për sy e faqe, vetëm na përcjellin pa kontrolle detale dhe analiza të nevojshme, kurse kur ka nevojë për intervenime, situata bëhet edhe më rëndë. Andaj edhe për intervenime shumë të vogëla jemi të detyruar ti drejtohem QKUK në Prishtinë.

Shqetësimet dhe lëndimet e rezidentëve: Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar me aplikimin e ditarit të veçantë për shqetësimet dhe gjendjen e krizave për rezidentët tanë si dhe mënyren e tejkallimit të këtyre krizave.

Jetulla Hoti nga fillimi i vitit ka shfaqur shenja të përmisimit të gjendjes emocionale dhe psikologjike.

Rezidenti tani është më komunikativ, më relaksues, më bashkpunues dhe po tregon për nevojat e veta qoftë emocionale, fiziologjike etj.

K. Fazliu: Gjatë kësaj periudhe rezidentja ka shfaqur shenja agresiviteti, epilepsi. Andaj gjatë kësaj periudhe i gjithë stafi ka qenë i angazhuar në trajtimin, përcilljen dhe menaxhimin e situatës së saj.

Situata e tanishme e rezidentës është jo stabile me tendencë agresiviteti, ku jemi duke vazhduar me angazhim të shtuar dhe mbikqyrje të veçantë ndaj saj.

D. Jashari –kjo rezidente ka problem të theksuara me gjëllitjen e ushqimit, dhe herëpas herë i mbetet ushqimi në fyt.

Duhet të theksojmë se nga njëmbëdhjetë (11) rezidentë të cilët i kemi në përkujdesje në institucionin tonë, 4 (katër) prej tyre nuk janë në gjendje të përkujdesen për veten e tyre, dhe nuk kanë njohuri për kryerjen e nevojave fiziologjike, andaj këta rezidentë gjithmonë janë të veshur me pampers për 24 orë në ditë, dhe kujdesi ndaj tyre është më i shtuar. Kurse rezidentët e tjerë mund të themi se janë në gjendje më të mirë dhe kanë një përkujdesje minimale për veten e tyre.

Si konkluzion të përgjithshëm mund të nxjerrim me sa vijon: Falë angazhimit të stafit punues, trajtimeve shëndetësore dhe emocionale, punës okupuese, hixhenës, ushqimit kualitativ dhe përkujdesjes së përgjithshme kemi arritur ta mbajmë një situatë relativisht stabile me disa përjashtime sa i përket shëndetit, por njëkohësisht kemi mbajtur një situatë të mirë emocionale dhe psikologjike për rezidentët duke ju plotësuar kërkesat dhe nevojat e tyre.

FURNIZIMI ME BARËNA , USHQIM , MATERIAL HIXHENIK DHE TJERA

Furnizimi me barëna : Gjatë kësaj periudhe të vitit kemi patur kontratë për furnizim me barëna , ku operatori ekonomik na ka furnizuar me barëna konformë kërkesave tona. Andaj mund të përfundojmë se kemi patur të gjitha barënat e nevojshme të cilat kanë qenë në kontratën për furnizime. Por sfida e jona mbetet si të sigurojmë barënat emergjente të cilat nuk i kemi në kontratë ,por në raste të ndryshme rekomandohen nga mjekët varësisht nga natyra e sëmundjeve apo rasteve emergjente.

Furnizimi me ushqim: Furnizimin me ushqim e kemi kontratën nga niveli qendror (AQP) ku është e shpërnadrë në disa Lote. Kompanitë kontraktuese na kanë furnizuar mirë dhe në pajtim me kërkesat tona. Ushqimi për rezidentët dhe stafinë përgaditet në kuzhinën e institucionit,ku rezidentët gjatë ditës shërbehen me tri shujta të ngrohta,por shërbehen edhe në mes të shujtave-në ora 11.00 shërbehen me kafe dhe keksa , kurse në ora 16.00 shërbehen me lëngje , ëmbëlsira të ndryshme apo pemë.

Kuzhinierja punon 5 ditë në javë,ku përgaditet ushqimin për rezidentët dhe stafinë, duke respektuar menynë e caktuar, por ka edhe përjashtime nga menya sipas kërkesave të rezidentëve, dietave të ndryshme, mungesave të ndonjë artikulli e të ngjashme. .

Gjatë vikendeve ushqimin e përgadisnin stafi i cili është në ndërrim duke respektuar menynë e caktuar si ditëve të tjera.

Angazhimi i kuzhinieres ka qenë i domosdoshëm dhe e ka rritur efikasitetin,kualitetin,në përgaditjen e ushqimit dhe servimit për rezidentët e vendosur në institucion..Si konkluzion mund të nxjerrim se kemi patur ushqimin e mjaftueshëm dhe cilësor për nevojat të vendosur në institucionin tonë.

Furnizimi me material hixhenik: Gjatë kësaj periudhe kemi patur furnizim me material të nevojshëm hixhenik dhe kemi mbajtur në nivelin e dëshirueshëm hixhenën personale,institucionale në përgjithësi.

Furnizimi me veshmbathje: Sa i përket veshmbathjeve për rezidentët kemi probleme të theksuar sidomos në veshjet e brendshme të rezidentëve për faktin se kërkesa për tenderim nga viti 2023 ende nuk është realizuar dhe vazhdon të qëndroj nëpër zyret e prokurimit , pasi

një nga operatorët ka paraqitur ankesë në AQP dhe ende vazhdojnë procedurat, kurse qarqafet, batanijet, jargonet I kemi patur te mjaftushem gjat kesaj periudhe.

Furnizimi me tekstil eshte bere vitin 2025 dhe gjatë vitit kemi veshmathjen e mjaftueshme si në veshjet e rezidentëve dhe me mbulojat e tyre. Por gjatë vitit kemi të planifikuar furnizimin me dyshekë të cilët janë dëmtuar dhe vjetëruar dukshëm.

Furnizimi me material për mirëmbajtjen e ndërtesave: Gjatë periudhe kemi patura materialin e mjaftushëm per mirmbajtjen e ndertesave.

Furnizimi me material administrativ për zyrë: Gjatë kesaj peridhe te vitit kemi patur furnizim me material zyrje dhe funksionimi i zyres ka qenë pa ndonjë problem.

Shpenzimi i parasë së imët: Gjatë kesaj peridhe të vitit nga paraja e imët kemi shpenzuar në ato raste si servisime, furnizime të ndryshme dhe analiza të ndryshme laboratorike..

Mirëmbajten e parkut,,mirëmbajtjen e paisjeve të shumta që i posedojmë,hixhienën si të institucionit,pastrimin e rezidentëve,pastrimin e rrobave,mirëmbajtjen e kopshtit dhe qdo gjë tjetër është mirëmbajtur nga stafi i institucionit,duke u kujdesur 24 orë në ditë për të gjitha punët.

Aktivitetet e stafit me rezidentët – Puna okupuese dhe relaksuese

Gjatë kësaj periudhe aktivitetet dhe puna okupuese, ka qene e organizuar në paisjet e fitnesit, lojra të ndryshme , shiqimin e televizionit, shëtitje në shtratin e lumit, gjimnastik organizimi i pik-niqeve në natyë etj.. gjithëashtu kohën e lirë rezidentët e kanë kaluar në hixhenen personale dhe jemi mundur ti shtojmë aftëstë e tyre për vetëkujdesje.

Gjatë kësaj periudhe kemi organizuar dy ditë piknik nje ditor ne natyre. Poashtu gjatë muajit Qershor 2026 kemi të planifikuar organizimine ekskurzionit tre ditor në Prizeren.

Vizitat nga familjarët dhe stafi i QPS-ve

Gjatë kësaj periudhe vizitat nga familjarët e rezidentëve dhe nga përfaqsesit e QPS-ve kanë qenë si në vijim:

Tabela në vijim paraqet vizitat e përgjithëshme për periudhën Janar-Qershor 2026

Emri i rezidentit të vizituar	vizita	vikend	Numri i vizitave nga QPS -e	Vizita tjera	Verejtje
Jetullah Hoti	32	13			
Zhivka Naskovic	3				
Kosovare Fazliu	0				
Xhylferie Vllasaliu	2	0			
Drita Jahsari	2	0			

Ibadete Ibrahimi	2	0			
Bukurie Zeneli	2	1			
Shukrie Ahmeti	0	0			
Bekim Berisha			1		
Totali	43	14	1		

Vizitat për rezidentët janë shumë domethanëse, po ndikojnë pozitivisht në relaksim dhe gjendjen e përgjithëshme emocionale të tyre.

Por, vizitat nga QPS-e prej nga vijnë rezidentët nuk janë të mjaftueshme ,prandaj duhet ta shtojmë angazhimin në bashkëpunimin me QPS-e dhe familjet e rezidentëve ku është e mundur.

KONTRATAT QË MENAXHOHEN PREJ STAFIT SH.K. KAMENICË

Zyrtarët e Institucionit Shtëpia e Komunitetit në Kamenicë menaxhojnë katër kontrata për furnizime me ushqim dhe pije:

1. Zyrtari Jahi Dërmaku është Menaxhe i Kontratës “ Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor ”LOT 5” me nr. Identifikues : UA/2016-24-8838-1-1-1/C626 , i datës 01.09.2025 dhe përfundon me datë 31.08.2026 .Operatori Ekonomik është “Dauti Comerc ” SH.P.K. me seli në Ferizaj.

Email: dautitender@hotmail.com Vlera e kontratës është: 1047900.80 € (Niveli Qendror AQP)

2. Zyrtari Jahi Dërmaku është Menaxhe i Kontratës “ Furnizim me Qumësht dhe Produkte Qumshti ” LOT 3 me nr. Identifikues : UA/2016-24-8838-1-1-1/C624 , i datës 03.09.2025 dhe përfundon me datë 02.09.2026 .Operatori Ekonomik është “ Beni Dona Plast ” SH.P.K. me seli në Prishtinë.

Vlera e kontratës është: 600975.00 € (Niveli Qendror AQP)

3. Zyrtarja Leorenta Mujaj eshte menaxhere e kontrates “ Furnizim me Pemë dhe Perime” KM653-25-8159-5-5-8 dhe me numer te AQP-se UA/2016-24-3651-1-1-1 /C506 deri C516 dhe sipas Kontratës të Komunës së Kamenicës me nr. 29471 i datës 20.10.2025 e cila fillon me datë 20.10.2025 dhe përfundon me datë 20.04.2026 , në shumen 3200.00 Euro.
4. Zyrtarj Xhevrije Ramnabaja është Menaxhere e kontratës “ Furnizim me Mish Gjedhi dhe Produkte të Mishit të Gjedhit ” LOT 1, me numër të kontratës UA/2016-25-4995-1-1-1/C 745, i datës 09.09.2025. Kontrata fillon me datë 15.12.2025 dhe përfundon me datë 14.12..2026, kurse vlera e kontratës është 699300.00 €.
5. Zyrtarj Xhevrije Ramnabaja është Menaxhere e kontratës “ Furnizim me Mish pule dhe Produkte të Mishit të Pules” LOT 2, me numër të kontratës UA/2016-25-4995-1-1-1/C 744, i datës 05.09.2025. Kontrata fillon me datë 01.12.2025 dhe
6. përfundon me datë 30.11.2026, kurse vlera e kontratës është 1.687.600.00 €.

Gjatë kësaj periudhe kam menaxhuar dhe përcjell realizimin e kërkesave tona, duke kompletuar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke qenë në vazhdimësi në kontakt me zyren e prokurimit dhe zyren e financave.

Me vendim të kryetarit të komunës kom qenë i caktuar Zyrtar Autorizues në këto projekte :

1. Blerja e Paisjev për Kuzhinë për Shtëpinë e Komunitetit në Kamenicë (Investim Kapital)
2. Furnizim më Pemë dhe Perime
3. Sherbimet e konsulentes se Psikiatrit.
4. Sherbimet e transportit dhe akomodimit.

Shpenzimet e komunalive janar –Qershor 2026

SH.K.Kamenice

muaji	Uje	Rryme	mbeturin a	telefon	verejtje
Janar	99.49	536.74	34.60	19.51	
shkurt	109.43	611.25	34.60	19.51	
Mars	115.01	517.83	34.60	19.51	
Prill	42.55	465.51	34.60	19.51	
Maj	100.52	452.26			
Qershor					

Korrik						
Gusht						
Shtator						
Tetor						
ntor						
dhjetor						
gjithsej	467.00	2,583.59	138.40	78.04		

Drejtoria për Investime Kapitale:

RAPORTIM MBI AKTIVITETET E REALIZUARA NË GJASHTË MUJORIN TË PARË TË VITIT 2026

AKTIVITETETI I PARAPARË	REZULTATET E ARRITURA	KOHA E FILLIMIT	A ËSHTË MBYLLUR AKTIVITETI?	PERSONI/AT PËRGJEGJËS	MBËSHTETJA E NEVOJITUR
Nisja e procedurave të prokurimit për investimet kapitale që janë të planifikuara për muajt Janar – Qershor.	Inicimi i procedurave të prokurimit si dhe projektet e përfunduara.	01.06.2026			
Inicimi i procedurave të prokurimit: <u>Lënda e kësaj kontrate është:</u> Hartimi i projekteve në Komunë e Kamenices	Lenda është ne prokurim.	05.06.2026	PO	Blerim Murina	ZKA, ZP, DBF.
Inicimi i procedurave të prokurimit: Ndertimi I trotuareve ne Kamenice dhe fshatra (Kopernice, Karaqeve, Rogane, Hogosht) faza 2	Janë përfunduar projektet dhe jemi ne fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	18.06.2026	JO	Blerim Murina	ZKA, ZP, DBF.

Inicimi i procedurave të prokurimit: Asfaltimi i rrugëve në Kamenice dhe fshatra – Faza III (Roganë, Hodonovc, Koretin, Petrit, Tygjec, Kopernicë, Hogosht, Busavatë, Berivojcë, Karaqevë)	Janë përfunduar projektet dhe jemi ne fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	18.06.2026	JO	Blerim Murina	ZKA , DBF.
Inicimi i procedurave të prokurimit: Participim me donator - Rregullimi i varrezave në fshatin Karaqevë e epërme	Është përfunduar projekti dhe jemi në fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	18.06.2026	JO	Blerim Murina	ZKA, DBF.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I PUNËS PËRGJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

2.1 Në Drejtorinë për Investime Kapitale, menaxherët e kontratave gjatë kësaj periudhe kohore kanë qenë të angazhuar në këto aktivitete:

- Menaxhimi-Mbikeqyrja e projekteve të ndërtimit, riparimit të infrastrukturës dhe objekteve tjera publike në tërë teritorin e Komunës së Kamenicës, investime nga buxheti Vetanak, Organizata tjera buxhetore dhe Donatorë të ndryshëm,
- Pjesëmarja në komisionet për vlerësimin e ofertave në zyrën e prokurimit.

-Takime me qëllim të informimit rreth projekteve të Investimeve Kapitale.

-Konsultime të ndryshme me pale.

.Shqyrtimi I kerkesave te qytetar, etj...

SHQYRTIMI I KËRKESAVE TË PALËVE

Në këtë periudhë kohore **Janar - Qershor 2026**, në Drejtorinë për Investime Kapitale janë pranuar gjithësej (**103**) kërkesa, ankesa dhe parashtrës të ndryshme:

- Kërkesë për rregullim të infrastrukturës (rrugë , trotuare)	93
- Ankesa gjatë punimeve të punëve në infrastrukturë rrugore në asfaltim	7
- Kërkesa të ndryshme	3

Për kërkesat e shqyrtuara është vendosur :

-Pozitive	16
-Negative	7
-Në procedurë për shqyrtim	80

1. KONTRATAT QË MENAXHOHEN NGA MENAXHERET E INVESTIMEVE KAPITALE

Imran Morina menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:

- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i Rrugeve Komunale LOT 2”
- Menaxher i kontratës “LOT 2 Lisocke- Shahiq- Zhuje”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i stadiumit në Hogosht, Kamenicë-Ritenderim”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i trotuareve në Kamenicë-Shipashnicë e ulët ,Hodonoc dhe Karaçevë e Poshtme dhe Busavatë”
- Menaxher i kontratës “Rregullimi i infrastruktures ne rrugen Kryesore dhe tranziti i qytetit Kamenice”
- Menaxher i kontratës “Krahu 1, Rruga Korqa Gmice dhe Koretin Berivojce”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë-Punët e mbetura-Ritenderim-3”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimet e rrugeve ne Shipashnice te eperme”
- Menaxher i kontratës “Mirembajtja e kanalizimit dhe infrastruktures komunale”
- Menaxher i kontratës “LOT 3 Asfaltimi i rrugeve ne Kamenice dhe Topanice”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i rrugve Livaxhet, Zajqeci, Mahmuti dhe Ahmeti”
- Menaxher i kontratës ”LOT 1 Kapi – Sfirce”

- Menaxher i kontrates “Mirmbajtja verore dhe dimerore e rrugeve locale dhe mirmbajtja e rrugeve te rendit te trete”

Amire Rexha menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:

- Menaxher i kontratës “LOT 3 Shahiq-Sfirce”
- Menaxher i kontratës “Participimi me donatorë-Asfaltimi i rrugëve në Karaqevë të Epërme”
- Menaxher i kontratës “LOT 1 Poliqkë-Desivojcë-Vriçec”
- Menaxher i kontrates “Furnizim me lodra për parqe”
- Menaxher i kontrates “LOT 2 – Ndërtimi i rrugës qarkore në Kamenicë Krahu 2”
- Menaxher i kontrates “LOT 2 – Asfaltimi i rrugëve në Hodonovc, Roganë dhe Muqivërcë”
- Menaxher i kontrates “Ndërtimi i qendrave Vieë Point dhe mbuloja për Zip Line-Ritenderim”

➤ Vlonë Matoshi menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:

- Menaxhere e kontratës “Ndërtimi i pritoreve të autobusëve-Ritenderim 3”
- Menaxhere e kontratës “LOT-1-Ndërtimi i Çerdhës në Roganë-Kamenicë”
- Menaxher I kontrates “Participimi me donator - Parku i Aventurave-Ritenderim”
- Menaxher i kontrates “Ndertimi I varrezave ne Hodonoc”

- Menaxher i kontrates “Ndarja e dhomave te mesimit dhe adaptimit te objektit te qendres se karrieres”
- Menaxher i kotrates “Studimi I fizibilitetit te zones ekonomike”

Vjollca Kryeziu menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:

- Menaxher i kontratës “Rehabilitimi i rruges Kolloleq-Dajkoc-Muqivërcë”
- Menaxher i kontratës “Mirembajtja e tereneve sportive te hapura dhe te mbyllura”
- Menaxher i kontrates “Ndërtimi I zhveshtoreve ne Stadiumin e Shipashnices se Eperme”
- Menaxher i kontrates “Lumi Astrit”
- Menaxher I kontrates “LOT 1 – Kamenicë-Muqivërcë-Berivojcë”
- Menaxher I kontrates “Rehabilitimi I kanalizimit atmosferik pergjate rruges kryesore “ Rafet Isufi” – Koretin.

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca:

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca, ka kryer obligimet dhe detyrat e veta konform Ligjeve dhe Akteve tjera nënligjore, Rregulloreve Komunale dhe Vendimit për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorive të Administratës Komunale. Kjo drejtori në kuadër të saj i ka 4 (katër) sektorë.

- Sektori i ShP (Shërbimeve Publike);
- Sektori për MMA (Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit);
- Sektori i Inspektoratit dhe
- Sektori për Emergjenca.

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE (SHP) DHE SEKTORI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE, DHE AMBIENTIT (MMA)

❖ Stafi

- Udhëheqës i Sektorit të SHP, 1
- Udhëheqës i Sektorit për MMA, 1
- Zyrtar i ambientit, 1
- Zyrtar për KEK dhe PTK, 1
- Zyrtar administrativ, 1
- Mirëmbajtës të ambientit, 3
- Zyrtarë administrativ (praktikant me kontratë 3 vjeçare), 2

Duke pasur para sysh Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë sipas kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka një përgjegjësi të theksuar në kryerjen e detyrave të ndryshme në infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen e rrugëve, sinjalizimin e rrugëve, mirëmbajtjen e ambientit, hapësirat publike, gjithashtu është përgjegjëse për të bashkëpunuar në fushën e mbeturinave, dhe ujtësjellësit me kompanitë përgjegjëse, atëherë mundë të konstatojmë se kjo drejtori punon me një numër jo të mjaftueshëm të stafit.

❖ **Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra publike**

Për mirëmbajtjen e hapësirave publike, është e kontraktuar NPL “Dardana” Sh.a. e cila kujdeset dhe mirëmban hapësirat publike në qytetin e Kamenicës, varrezat dhe lapidarët e dëshmorëve. Komuna ka nënshkruar një kontratë me NPL “Dardana” Sh.A. e cila ka marrë për sipër mirëmbajtjen e të gjitha hapësirave publike si dhe menaxhimin e Zip-line. Hapësirat publike të cilat përfshihen në kontratë fillojnë nga Berivojca, rruga “Adem Jashari” në dy anët e rrugës ku përfshihet edhe mirëmbajtja e trotuareve dhe pastrimi i rrugës, mirëmbajtja e drunjëve dekorativ duke vazhduar në rrugën “Skënderbeu” ku përfshihen të gjitha hapësirat publike në dy anët e rrugës, bulevardi i qytetit, trotuaret dhe hapësirat tjera deri te ura që kalon në lagjen “Malësia”. Po ashtu përfshihet edhe përroi i Rubocit që vazhdohet me mirëmbajtje deri ish stacioni i autobusëve. Këto hapësira që i cekëm më lartë mirëmbahen në mënyrë intensive në baza ditore, por mirëmbajtja bëhet edhe në rrugët tjera në qytet si: në rrugën “Sylë Zarinca”, Rrugën “Tahir Sinani, dhe rrugë tjera sipas nevojës.

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m ²)
1	Mirëmbajtja intensive e hapësirave gjelbëruese	92,994.00
2	Pastrimi i lumit të qytetit	59,500.00
3	Varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët	31,886.00
Sipërfaqja e përgjithshme (m²)		184,380.00 m²

Përveç këtyre bëhet mirëmbajtja lapidareve dhe varrezave të dëshmorëve, mirëmbajtja e shtratit të lumit etj. Gjithashtu sipas kërkesave të këshillave lokale bëhet edhe pastrimi i varrezave në qytet dhe lokalitete tjera, varësisht nga gjendja e tyre. Edhe punëtorët e mirëmbajtjes nga drejtoria jonë janë gjithmonë në terren dhe ndihmojnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave tjera publike të pa përfshira në kontratë, e që vlerësohet se ka nevojë të pastrohen. Në tabelën e më poshtme do ti paraqesim sipërfaqen e hapësirave publike, gjelbëruese që mirëmbahet rregullisht në mënyrë intensive sipas kontratës.

Tabela Nr. 1; Sipërfaqet e Hapësirave të gjelbra publike

Realizimi i projekteve dhe kryerja e aktiviteteve të ndryshme

- **Lirimi i hapësirave publike.** Largimi i objekteve montazhe nga prona Komunale duke i përfshi Kioskat dhe garazhet në qytetin e Kamenicës dhe në Berivojcë. Pas marrjes së vendimit nga Kuvendi Komunal për anulimin lejeve të kioskave dhe garazheve – për lirin e hapësirave publike, drejtoria jonë ka marrë të gjitha masat e nevojshme ku me datë 28 Janar i kemi njoftuar me shkrim pronarët e disa objekteve montazhe që duhet ta lirojnë hapësirën publike, pronarët e kioskave dhe garazheve, ku ju kemi dhënë një afat që më së

largu deri më 31 Mars, të bëjnë largimin e tyre nga hapësira publike. Gjithashtu është kërkuar nga pronarët e tyre edhe kryerja e obligimeve financiare ndaj Komunës brenda këtij afati.

Tani ky aksion ka përfunduar me sukses ku janë larguar të gjitha objektet e tyre nga hapësira publike, dhe gjithashtu është bërë edhe pastrimi i vendeve nga punëtorët e NPL , punëtorët e ambientit si dhe nga kompania e kontraktuar.

Rregullimi i disa parqeve dhe kënde të lojërave në disa lokalitete:

- **Rregullimi i parkut dhe këndit të lojërave në Shipashnicë të Epërme**, vlera totale e projektit të realizuar është 9,184.00 € . Projekti është realizuar në tërësi.

- **Rregullimi i parkut dhe këndit të lojërave në Shipashnicë të Poshtme**, vlera e projektit është 8,543.00€, dhe realizimi i përfunduar në tërësi.

- **Rregullimi i parkut dhe këndit të lojërave në Petroc**, vlera e projektit është 13,948.00€, punët kanë përfunduar në tërësi.

- **Rregullimi i parkut dhe këndit të lojërave në Rogaqicë**, vlera totale e projektit është 17,138.00 €. Projekti është realizuar në tërësi.

- **Vendosja e mini parkut dhe vendosja e ulëseve në Karaqevë**, vlera totale e realizimit të projektit është 2,640.00 €, dhe punët kanë përfunduar në tërësi.

- **Vendosja Ulëseve në Hogosht te Qurreli**, vlera totale është 900.00 €

- **Rregullimi i parkut dhe këndit të lojërave në lagjen e Bajrovite në Busavatë**, vlera e projektit është 7,120.00 €. Janë siguruar të gjitha pajisjet për këndin e lojërave por ditët në vijim pritet edhe përfundimi i këtij projekti.

- **Evidentimi i deponive ilegale brenda territorit të komunës së Kamenicës.** Nga zyrtarët e drejtorisë është formuar një komision i cili ka dalë në terren dhe i ka evidentuar të gjitha deponitë ilegale në të gjithë territorin e komunës së Kamenicës, ku janë të shënuara koordinatat për secilin lokalitet. Evidentimi i deponive ka përfunduar më 25 Shkurt ku në total janë evidentuar 20 deponi

ilegale ku prej tyre janë: 7 deponi të mëdha, 11 deponi të mesme dhe 2 deponi të vogla. Nga data 25 shkurt në disa vende ka filluar pastrimi i deponive, por si problem është ngarkuesi i komunës i cili ishte jo funksional dhe deri në riparimin e tij kemi vonesa në eliminimin e deponive ilegale. Pas riparimit menjëherë ka fillu largimi i deponive ilegale.

- **Përgatitja e Raportit Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave, për vitin 2025 dhe raportimi në AMMK (Agjencinë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës).** Është përgatitur Raporti Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave, ku pas finalizimit dhe marrjes së të dhënave nga kompania që e bën bartjen e mbeturinave Ecohigjiena, është finalizuar raporti dhe kemi raportuar në Ministrinë e Mjedisit përkatësisht në AMMK. Raporti është dorëzuar më 27 Mars 2026.

Në bazë të të dhënave deri në dhjetor të vitit 2025, mbulimi në shërbimin e rrjetit të mbeturinave në komunën e Kamenicës është: Për ekonomi familjare 92,68 % , për biznese 87,04 %, ndërsa te Institucionet publike mbulimi në shërbimin e rrjetit të mbeturinave është 100 %. Inkasimi për të gjitha kategoritë është realizuar 97,75 %.

- **Raportimi në Divizionin për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave,** Në këtë divizion përkatësisht në Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është raportuar lidhur me Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës 2024–2035 dhe Planin e Veprimit 2024–2026. Raportimi është bërë për vitin 2024 dhe vitin 2025, më datë 11 Mars 2026.

- **Performanca Komunale.** Në kuadër të raportimit për plotësimin e performances Komunale, të gjithë zyrtarët e drejtorisë që janë të emëruar me vendim të kryetarit, i kanë plotësuar me kohë të gjithë indikatorët në fushat përkatëse. Në kuadër të drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia për raportim janë gjithsejtë 6 fusha dhe 24 indikator që janë plotësuar dhe raportuar nga zyrtarët e drejtorisë. Në këtë raport krahasuar me atë të vitit 2024, kemi një rritje të përqindjes në 5 fusha për 7 indikator me një përqindje të theksuar, që fillon nga 3,93 % deri në 100 %.

❖ **Aksionet dhe fushatat e pastrimit të ambientit**

Në këtë periudhë kemi planifikuar, dhe realizuar disa aksione për pastrimin e ambientit, edhe atë:

- **Me 22 Prill për nder të ditës së tokës është organizuar një aksion për pastrimin e mjedisit.** Nga Sektori për MMA (menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit) është përgaditur plani për organizimin e aksionit “Për një Kamenicë të Paster”, që është mbajtur më 22 Prill 2026 për nder të Ditës së Tokës. Plan i është aprovuar nga kryetari i Komunës dhe aksioni është kryer me sukses. Në këtë ditë në aksion kanë marrë pjesë përveç drejtorisë për shërbime publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia edhe të gjitha shkollat e Komunës së Kamenicës ku kanë pastruar hapësirat në afërsi të objekteve shkollore dhe rrugëve tjera në afërsi të shkollave. Gjithashtu kanë marrë pjesë edhe policia e Kosovës, punëtorët e NPL “Dardana”, KL, dhe qytetar tjerë vullnetar që i janë bashkuar aksionit. Në këtë ditë janë mbjellë edhe lule dhe drunj dekorativ te rrethi në qendër të qytetit si dhe te rrethi në afërsi të Rubocit. Pas përfundimit të aksionit thasët me mbeturina janë marrë nga kompania Ekohigjiena e cila ka bërë transportin e tyre për në deponinë qendrore.

- **Më 26 Maj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit,** është mbajtur aksioni “**Për një Kamenicë të pastër**”, ku është bërë pastrimin i disa deponive ilegale në qytet dhe lokalitete tjera si: Muqiverc, Ura e Dajkocit, , Katushnicë, Berivojcë, në rrugën e Tugjecit.

- **Më 5 Qershor, me rastin e ditës botërore të mjedisit** është organizuar aksion i pastrimit të ambientit si dhe eliminimi i disa deponive ilegale në qytet dhe vende tjera, në Stralicë, Strezoc, Krilevë, Grizime dhe Moqare.

- **Ndërrimi i lokacionit të këndi i parkut të qytetit te rruga “Tahir Sinani” për kontejnerët me mbeturina.** Duke pasur parasysh se lokacioni në skaj të parkut të qytetit ka shkaktuar probleme dhe pa siguri për qytetarët, kemi vendosur që kjo pikë të bartet për disa metra për ballë objektit të KRU “Hidromorava”, po ashtu në rrugën “Tahir Sinani”, ku kemi rregulluar rrugën me zhavorr dhe në

ditët në vijim do ti bartim kontejnerët e mbeturinave dhe ti vendosim në këtë vend. Gjithsesi do të njoftohen edhe qytetarët dhe kompania Ekohigjiena e cila bën bartjen e mbeturinave.

- **Renditja e tezgave te tregu dhe funksionalizimi i tregut në qytet.** Kemi mbajtur një takim me kompaninë ekohigjiena, dhe kemi kërkuar nga ta që të bëjnë pastrimin e hapësirës brenda tregut, të bëhet renditja e veprimtarive dhe caktimi i numrave të tezgave, dhe të njoftohen të gjithë tregtarët që të bëjnë rezervimin e tezgave brenda tregut dhe mos të lejohet shitja në parkingjet publike. Për prodhuesit vendorë të cilët merren me shitje sezonale, në mungesë të hapësirës brenda tregut do të lejohet rendi i parë i parkingjeve në afërsi të tregut sipas nevojës së prodhuesve vendorë. Tani jemi në fazën e fundit të rregullimit të tregut dhe në ditët në vijim do të filloj zbatimi i këtij plani.

- **Zgjerimin e rrjetit të mbeturinave në Busavatë.** Është përgatitur lista me ekonomitë familjare për Busavatë, ku ne do të koordinohemi me KL dhe të mbajmë një takim ku qytetarët do të pajisen me kontejner familjar 120 l, dhe të nënshkruajnë marrëveshje me kompaninë Ekohigjiena për marrjen e mbeturinave.

- **Pastrimi i prroit në Karaqevë të Epërme,** Është bërë pastrimi i prroit me një gjatësi rreth 300 m, ku janë larguar 1100 m³ sasi e dheut dhe shkurreve. Vlera totale e shpenzimeve për pastrimin e prroit në këtë lokacion është 16,500.00 €. Punët kanë përfunduar më 27.04.2026.

- **Pastrimi i një pjese të lumit në Hogosht.** Në këtë lokacion janë pastruar rreth 150 m të lumit të Hogoshtit. Punët kanë përfunduar më 02.05.2026, ku janë larguar rreth 190 m³ sasi e dheut dhe shkurreve të ndryshme. Vlera totale e shpenzimeve është 2,839.80€.

- **Rregullimi i rrugës te Varrezat e Dëshmorëve në Kamenicë.**

Është bërë rrafshimi dhe mbushja me zhavorr e rrugës së vjetër për Feriqevë, rruga në afërsi të parkut te pishat.

- **Mirëmbajtja e hapësirave publike,** Mirëmbajtja e hapësirave publike është e kontraktuar me NPL “Dardana” . Punët rreth mirëmbajtjes janë duke u zhvilluar në mënyrë të kënaqshme. Përveç mirëmbajtjes sipas kontratës, ka edhe pozicione tjera të cilat mirëmbahen nga punëtorët e mirëmbajtjes nga drejtoria jonë. Në mënyrë të rregullt pastrohen varrezat dhe lapidarët e dëshmorëve, bëhet ndërrimi i flamujve, si dhe intervenohet në rregullimin e rrugës në disa vende ku është e nevojshme.

- **Kryerja e punëve në kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë,** në bazë të kërkesave që kemi pasur janë kryer punët si në vijim:

- Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në fillim të vitit, është angazhuar makineria përkatëse për hapjen e rrugëve dhe sipas nevojës në disa vende rruga është shtruar edhe me zhavorr.

- Intervenimi në rrugën e Moçarit, duke përfshirë rregullimin e lëshesave ujore dhe furnizimin me zhavorr, me qëllim sigurimin e qarkullimit të rrugës drejt deponisë për mbeturina inerte, e cila gjendet në Moqare. Gjithashtu është intervenuar edhe rregullimi i uj lëshesave te një shtëpi për tej urës për Moqare, ku ka pasur dëmtim të rrugës pas vërshimeve.

- Intervenimi në rrugën e Krojeve, si pasojë e reshjeve dhe ndryshimit të rrjedhës së ujit, si dhe furnizimi me zhavorr në segmentet e dëmtuara.

- Trajtimi dhe furnizimi me zhavorr i rrugës në zonën kadastrale Hodonoc–Topanicë, konkretisht rruga për Starakuqë.

- Trajtimi i rrugës nga Kodra “Dëshmorët e Kombit” deri në Feriqevë, furnizimi me zhavorr në degëzimet e kësaj rruge.

- Trajtimi i një segmenti në rrugën e Lugut të Verdhë, duke përfshirë rregullimin e lëshesave gypore dhe furnizimin me zhavorr.

- Trajtimi dhe furnizimi me zhavorr i rrugës për në Rahovicë.

- Rrënimi i objektit të vjetër (ku janë kryer analizat) në kuadër të kompleksit të QKMF-së.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe punë të tjera mirëmbajtëse në përgjithësi, varësisht nga kërkesat dhe nevojat e paraqitura në terren, me qëllim mbajtjen funksionale dhe të sigurt të rrugëve lokale dhe të rendit të tretë.

- **Hartimi i Rregulloreve Komunale.** Tani për tani nga zyrtarët e drejtorisë tone janë duke u hartuar këto rregullore:

- **Rregullorja për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.** Hartimi i kësaj draft rregullore është në fazën e fundit ku javën e ardhshme do të publikohet në faqen e komunës për diskutim publik, kështu që pas kësaj do të mbahet edhe dëgjimi publik dhe pritët që në seancën e muajit Qershor të shkoj në Asamblenë Komunale për aprovim.

- **Plotësim ndryshimi i Rregullores për Parkingje.** Janë mbajtur tri takime deri më tani, ku janë disa paqartësi rreth disa neneve, (pas marrjes së vendimit nga gjykata supreme për shfuqizimin e disa neneve të rregullores për parkingje në Prishtinë, e që kanë ngjashmëri edhe te rregullorja e komunës tonë). Nga komisioni jemi dakorduar që të bëjmë një konsultë në Ministrinë përkatëse.

